




QKSS

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë



Doracak rreth kontekstit të terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm në Kosovë

Mars 2023




Autor: Garentina Kraja

Skënder Perteshi

Vërejtje: Ky raport është përgatitur në kuadër të projektit “Mbështetja profesionale e Shërbimit Sprovues të Kosovës në luftën kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm”, i zbatuar nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) dhe Qendra Ndërkombëtare për Kundër-Terrorizëm (ICCT) dhe financuar nga Mbretëria e Holandës dhe Ambasada Britanike në Prishtinë. Opinionet e shprehura në këtë raport nuk e pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimin dhe opinionet e Mbretërisë e Holandës dhe Ambasadës Britanike në Prishtinë.”

Ky aktivitet organizohet në kuadër të projektit “Mbështetja profesionale e Shërbimit Sprovues të Kosovës në luftën kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm” i mbështetur nga Mbretëria e Holandës dhe Ambasada Britanike në Prishtinë”.



DORACAK RRETH KONTEKSTIT TË TERRORIZMIT DHE EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM NË KOSOVË

Shkurt 2023

TABELA E PËRMBAJTJES

Rreth autorëve	1
Hyrje	2
1. Fillet e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit në Kosovë	3
2. Shtjellim dhe përmbledhje e praktikave më të mira ndërkombëtare që aplikohen sot nëpër shtetet evropiane nga shërbimet sprovuere në kuadër të programeve rehabilitues dhe reintegruese.	13
3. Procesi i rehabilitimit dhe reintegrimit	22
3.1 Cka është rehabilitimit dhe riintegrimi?	22
3.2 Për çfarë na duhen programet e rehabilitimit dhe riintegrimit?	24
3.3 Çfarë duhet të kemi parasysh para se të fillojmë me zbatimin e programit të rehabilitimit dhe riintegrimit?	24
3.4 Qasja: si të ndërtojmë besimin ndërmjet SHSK dhe luftëtarëve të huaj, gruas apo fëmiut të kthyer?	25
4. Termet dhe terminologjia	27

RRETH AUTORËVE



Garentina Kraja është studiuese, konsulente politikash dhe ligjeruese. Puna e saj fokusohet në ekstremizmin e dhunshëm, ndikimin malinj, nxitësit e rekrutimit në kryengritje dhe çështjet e drejtësisë tranzicionale. Ajo shërbeu si këshilltare për politikën e jashtme dhe sigurinë e Presidentes së Kosovës Atifete Jahjaga nga viti 2011 deri në vitin 2016. Më parë, Kraja ka punuar si korrespondente e Associated Press nga viti 2000 deri në vitin 2007 në Kosovë duke raportuar mbi mbikëqyrjen ndërkombëtare në Kosovë, tensionet etnike pas përfundimit të luftës dhe negociatat që çuan në shpalljen e pavarësisë së Kosovës. Kraja paraprakisht ka raportuar mbi luftën në Kosovë për të përditshmen Koha Ditore. Ajo gjithashtu ligjëroi në Universitetin Amerikan në Kosovë për politikën krahasuese, fenë dhe globalizimin dhe marrëdhëniet ndërkombëtare. Ajo mbanë diplomë BA dhe MA në shkencat politike nga Universiteti Yale.



Skënder Perteshi është analist dhe studiues i anti-terrorizmit dhe luftimit të ekstremizmit të dhunshëm në Qendrën Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS). Skënderi është autor i raporteve të shumta hulumtuese që lidhen me temat e sigurisë, siç janë lufta ndaj terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, ndërtimi i komuniteteve të qëndrueshme në Kosovë, diaspora dhe siguria, politika e jashtme dhe kërcënimet hibride. Perteshi ka punuar si bashkëpunëtor dhe konsulent për çështje të sigurisë në shumë organizata ndërkombëtare dhe vendore, përfshirë Fondacionin Finn Church Aid – Helsinki, Royal United Services Institute (RUSI), Organizata Ndërkombëtare e Migracionit (IOM), OSBE në Kosovë, kompania këshilluese MOONSHOT në Londër, Resolve Network USA, GCERF, dhe RAN. Kontakti: perteshi.skender@gmail.com or Skender.Perteshi@qkss.org

HYRJE

Analiza në vijim është një përmbledhje e gjetjeve të ndërtuara përgjatë një dekadë përmes hulumtimeve të Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë dhe ekspertëve që e kanë trajtuar radikalizimin në Kosovës përmes programeve të ndryshme me qëllim të identifikimit të shtytësve që i kanë nxitur shtetasit e Republikës së Kosovës t'i bashkangjiten grupacioneve terroriste në Lindje të Mesme dhe t'i përqafojnë kauzat ekstremiste. Kjo përmbledhje ka për qëllim të kontekstualizojë fenomenin e të ashtuquajturve "luftëtarë të huaj" që iu bashkangjiten organizatës terroriste të ashtuquajtur "Shteti Islamik" dhe organizatave tjera të përfshira në vatrat e luftës në Siri dhe Irak, dhe që përbënin sfidën e menjëhershme të institucioneve shtetërore të sigurisë së Kosovës.¹

Ndonëse secili rast është specifik, qëllimi i kësaj analize të shkurtër është të ofrojë një pasqyrë koncize për motivet individuale dhe kolektive që shtyen një pjesë të qytetarëve të Kosovës t'i bashkangjiten organizatave terroriste në Lindje të Mesme.

Një pasqyrë e tillë e rrethanave shtytëse është e domosdoshme për ta kuptuar kontekstin në të cilin bëhet rehabilitimi dhe reintegrimi i qytetarëve të Kosovës të riatdhesuar nga vatrat e luftës.

Ky doracak, përkundër fokusit në fenomenin e radikalizimit islamist që çon në ekstremizëm të dhunshëm definon edhe tipologjitë e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit, të cilat aktualisht përbëjnë rrezik për sigurinë kombëtare të Kosovës. Njëkohësisht, në mungesë të një praktike të vetme ndërkombëtare për t'u ballafaquar me rehabilitimin dhe reintegrimin e të individëve të radikalizuar, doracak u ofron një përmbledhje për nevojat e brendshme të personelit të Shërbimit Sprovues të Kosovës, duke identifikuar praktikën më të mira në përballje me një fenomen të ngjajshëm. Në fund, doracak u përmbledhë definicionet dhe terminologjinë bazike për nevojat e Shërbimit Sprovues të Kosovës në përpjekje për të standardizuar qasjen e shërbyesve të SHSK-së në përballje me individët që kalojnë nëpër këtë shërbim drejt rehabilitimit dhe reintegrimin të tyre në shoqëri dhe për ta lehtësuar komunikimin. Definicionet dhe terminologjitë bazike të trajtuara në këtë doracak poashtu do të ndihmojnë zyrtarët sprovues në rritjen e objektivitetit të zyrtarëve sprovues gjatë trajtimit të rasteve të R&R si dhe parandalon stigmën apo diskriminimin e pa-qëllimshëm të zyrtarëve sprovues ndaj të dënuarve për vepra të terrorizmit.

1 Perteshi, Skënder. 2018. "Beyond Triggers: New Threats of Violent Extremism in Kosovo," Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. https://qkss.org/images/uploads/files/violent-extremism-eng_611603.pdf

1. FILLET E EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM DHE RADIKALIZIMIT NË KOSOVË

Në periudhën mes viteve 2012 dhe 2016, qindra shtetas të Republikës së Kosovës i janë bashkangjitur grupeve terroriste dhe kauzave ekstremiste në Lindje të Mesme. Një pjesë e tyre fillimisht i janë bashkangjitur organizatave me agjendë islamiste, sikur grupit terrorist "Al Fateh al Sham" "Daesh"e të tjera, që luftonin regjimin diktatorial në Siri në kuadër të zhvillimeve që lidhen me të ashtuquajturën "Pranverë arabe." Megjithatë, derisa lufta në Siri degjeneroi, pjesa më e madhe e shtetasëve të Kosovës përfunduan në radhët e të ashtuquajturit Shteti Islamik, organizatë terroriste e cila kishte për qëllim krijimin e të ashtuquajturit "Kalifat" islamik dhe që për një kohë të caktuar kontrolloi pjesë të territoreve të Sirisë dhe Irakut.

Paraqitja e të ashtuquajturit fenomen të "luftëtarëve të huaj" në Kosovë tërhoqi vëmendje ndërkombëtare dhe të studiuesve për të kuptuar kontekstin në të cilin ndodhi një zhvillim i tillë duke marrë parasysh orientimin pro-perëndimor të vendit. Në studimet mbi ekstremizmin e dhunshëm në Kosovë, theks i veçantë është vënë te ndikimi nga jashtë të rrymave islamiste që nuk ishin të pranishme në Kosovë para luftës së viteve 1998-1999.² Në aspektin teorik, qëllimi i këtyre rrymave islamiste ishte të sfidonin bashkëjetesën tradicionale mes shtetit dhe fesë dhe t'i vendosin shtetin sekular dhe ideologjinë fetare në konkurrencë me njëra tjetrën në përpjekje për dominim.

Në aspektin praktik, në Kosovë, këto rryma kryesisht kanë tentuar që të polarizojnë dhe të përçajin komunitetin e besimtarëve myslimanë në Kosovë dhe e kanë propaguar ekstremizmin e dhunshëm si mjet për arritjen e qëllimeve të tyre politike. Në vizionin e tyre ideologjik dhe politik, këto rryma e kanë inkurajuar rekrutimin e luftëtarëve të huaj me kauza ekstremiste si përpjekje për të përfshirë Kosovën në të ashtuquajturën "Umma islamike," një koncept dhe hapësirë imagjinare që udhëheqësit e Shtetit Islamik e paramendonin si njësi territorial që bashkon tokat e banuara me popullatë myslimane. Në dogmën e tyre, feja islame, e interpretuar nga udhëheqësit e IS-it, do të ishin emëruesi i përbashkët identitar dhe dogma islamike do të ishte mënyrë e jetës. "Kalifati islamik" synohej të realizohej si manifestimi territorial i këtij koncepti ideologjik.³

2 Kursani, Shpend. 2015. "Report për shkaqet dhe pasojat e përfshirjes së qytetarëve të Kosovës si luftëtarë të huaj në Siri dhe Irak," Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. <https://qkss.org/en/publikimet/raport-per-shkaqet-dhe-pasojat-e-perfshirjes-se-qytetareve-te-kosoves-si-luftetare-te-huaj-ne-siri-dhe-irak>

3 Kraja, Garentina. 2017. "Narracioni i Shtetit Islamik, i dekonstruktuar hap pas hapi." Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. <https://qkss.org/en/publikimet/the-islamic-state-narrative-in-kosovo-deconstructed-one-story-at-a-time>

Fillet e kësaj fryme ideologjike në Kosovë vijnë nga prijës dhe influencues që kryesisht e kanë sfiduar hierarkinë e Bashkësisë Islame, institucion zyrtar fetar në Kosovë si dhe shtrirjen e saj rajonale nëpër Kosovë. Gjenezja e këtij problemi përkon edhe me luftën për pushtet dhe dominim të rrymave të ndryshme brenda kësaj bashkësie, eksponentë të së cilës në periudhën e pasluftës në Kosovë fillojnë të jenë më të pranishëm dhe më të zëshëm në sferën publike.⁴ Këto zhvillime sa janë të ndihmuar nga demokratizimi i Kosovës dhe liritë e avancuara individuale sikurse ajo zgjedhjes, e fjalës dhe së të drejtës për asociim, aq janë të mundësuar nga shtrirja dhe zgjerimi i përdorimit të internetit në Kosovë dhe ndryshimi i sferës mediale për t'iu përshtatur konsumimit të lajmeve nga audienca.⁵ Këto ndryshime në Kosovë gjatë dy dekadave të fundit përbëjnë vetëm disa nga faktorët strukturor që i kanë ndihmuar në formë indirekte depërtimit dhe ndikimit të rrymave radikale nga jashtë Kosovës, duke u dhënë mundësi eksponentëve të IS-it dhe simpatizantëve të tyre në Kosovë të komunikojnë pa filtra dhe pa ndërmjetësim pavarësisht mungesës së kredencialeve në ligjerimin fetar apo për kontekstin e luftërave në Lindje të Mesme. Një situatë e këtillë i ka mundësuar "Shtetit Islamik" ta bëjë indoktrinimin përmes propagandës së tyre përmes internetit dhe rekrutimin e individëve përmes mediave sociale, pa pasur nevojë që të jetë e lidhur gjeografikisht me një rajon të caktuar.⁶

Krahas faktorëve strukturor që ndihmuar në mënyrë indirekte shtrirjen e ndikimit të ekstremizmit të dhunshëm në Kosovë, ishin edhe një sërë faktorësh të brendshëm që ndikuan në rritjen e kësaj fryme. Në periudhën mes viteve 2012-2016, autoritetet në Kosovë identifikuan dhjetëra hapësira që luanin rolin e xhamive të paautorizuara, të cilat operonin pa miratimin e BIK-ut dhe shpeshherë paralelisht ose në konkurrencë me hoxhallarët që i shërbenin komunitetit të besimtarëve në nivel lokal. Të tilla ishin Xhamia el-Kudus në Gjilan, një xhami e improvizuar në lagjen Dardania dhe pranë ngrohtores së kryeqytetit në Prishtinë. Numri i këtyre vend takimeve ilegale deri në vitin 2012 kishte arritur në 100 dhe pavarësisht se një pjesë e tyre ishin denoncuar nga BIK-u pranë autoriteteve përkatëse, ato kishin vazhduar të vepronin të papënguar.⁷ Një pjesë e konsiderueshme e "luftëtarëve të huaj" nga Kosova ishte indoktrinu

4 Jakupi, Rudinë dhe Garentina Kraja. 2018. "Accounting for the Difference: Vulnerability and Resilience to Violent Extremism in Kosovo. Country Report 3." Berlin/Prishtina. Berghof Foundation dhe Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë https://qkss.org/images/uploads/files/CTR_CaseStudy3_kosovo_ENG_574166.pdf

5 Kraja, Garentina. 2021. "Cultural Drivers of Radicalization in Kosovo." D.Rad: DeRadicalization in Europe and Beyond: Detect, Resolve, Reintegrate and Kosovo Center for Security Studies. <https://dradproject.com/?publications=cultural-drivers-of-radicalisation-in-kosovo>

6 Shtuni, Adrian. 2016. "Dynamics of Radicalization and Violent Extremism in Kosovo." Washington: US Institute of Peace, Special Report 397, <https://www.usip.org/sites/default/files/SR397-Dynamics-of-Radicalization-and-Violent-Extremism-in-Kosovo.pdf> and Kelmendi, Vese and Shpat Balaj. 2017. "New Battlegrounds: Extremists groups' activity on social networks in Kosovo, Albania and FYROM." Kosovo Center for Security Studies. <https://qkss.org/en/publikimet/fushbetejat-e-reja-aktiviteti-i-grupeve-ekstremiste-ne-rrejetet-soziale-ne-kosove-shqiperi-dhe-maqedoni>.

7 Xharra, Besiana. "Kosova Mbylle Syte para Xhamive Ilegale" (Kosovo Turns a Blind Eye to Illegal Mosques," Balkan Insight, January 12, 2012. <https://balkaninsight.com/2012/01/12/kosovo-turns-blind-eye-to-illegal-mosques/>

dhe rekrutuar për të luftuar në radhët e organizatave terroriste në Lindje të Mesme në këto hapësira nga individë që kishin luajtur rolin e hoxhallarëve të paautorizuar, por edhe nga prijës fetarë që në Shtetin Islamik panë moment për të zgjeruar ndikimin e tyre te besimtarët myslimanë në Kosovë.⁸

Krahas faktorëve strukturor dhe rrethanave specifike të Kosovës si shoqëri në tranzicion, një numër studiuesish e vendosën theksin edhe te faktorë të tjerë të brendshëm sikur që është shtrirja joadekuate e institucioneve në tërësinë territoriale të vendit, klientelizmin dhe korrupsionin që i rezervon përfitimet e përgjithshme shoqërore për një grup të caktuar shoqëror të afërt me njerëzit me pushtet dhe te një dëshprim nga shtesa të caktuara shoqërore për një rend të ri politik ku ata nuk po ndiheshin të përfaqësuar dhe të dëgjuar.⁹ Rekrutimin e “Shtetit Islamik” në Kosovë e ndihmuan në mënyre indirekte edhe rrethana të tjera si lidhjet e ngushta familjare dhe karakteristikat e tjera të shoqërive të vogla ku të gjithë kanë njohuri të njëri-tjetrit.¹⁰ Shumica e të rekrutuarve besohet ta kenë njohur njëri tjetrin paraprakisht dhe gati gjysma e tyre kanë pasur lidhje të ngushta familjare mes vete.

Motivet tjera që identifikohen si shtytës janë kryesisht faktorët individual që mund t'i kenë nxitur shtetasit e Kosoëvs t'i përqafojnë këto kauza ekstreme. Ato ndër të tjera përfshijnë bindjet rreth kauzave për të cilat janë thirrur t'iu bashkangjiten organizatave terroriste, religjiozitetin, traumat e ndryshme, gjendjen e rëndë ekonomike dhe izolimin shoqëror.¹¹ Studiuesit poashtu kanë arritur të konkludojnë që një pjesë e konsiderueshme e të radikalizuarve kanë pasur të kaluar penale dhe një pjesë tjetër kishin njohuri të cekta fetare të cilat i kanë bërë ata pre të propagandës së “Shtetit Islamik”.¹²

Këto rryma radikale që e kanë inspiruar ekstremizmin e dhunshëm kanë pasur për qëllim kryesor ta sfidojnë rendin demokratik në Kosovë dhe ndërtimin e shtetit sekular, të përcaktuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.¹³ Në

8 Kursani, Shpend. 2015. “Report Inquiring into the Causes and Consequences of Kosovo Citizens’ Involvement as Foreign Fighters in Syria and Iraq.” Kosovar Center for Security Studies. <https://qkss.org/en/publikimet/raport-per-shkaqet-dhe-pasojat-e-perfshierjes-se-qytetareve-te-kosoves-si-luftetare-te-huaj-ne-siri-dhe-irak>

9 Jakupi, Rudine and Garentina Kraja. 2018. “Accounting for the Difference: Vulnerability and Resilience to Violent Extremism in Kosovo. Country Report 3.” Berlin/Prishtina. Berghof Foundation and Kosovar Center for Security Studies. https://qkss.org/images/uploads/files/CTR_CaseStudy3_kosovo_ENG_574166.pdf

10 Kursani, Shpend. 2018. “Kosovo Report” in Extremism Research Forum/Western Balkans. https://kosovo.britishcouncil.org/sites/default/files/erf_report_kosovo_2018.pdf

11 Shtuni, Adrian. 2016. “Dynamics of Radicalization and Violent Extremism in Kosovo.” Washington: US Institute of Peace, Special Report 397, <https://www.usip.org/sites/default/files/SR397-Dynamics-of-Radicalization-and-Violent-Extremism-in-Kosovo.pdf>

12 Kursani, Shpend. 2015. “Report Inquiring into the Causes and Consequences of Kosovo Citizens’ Involvement as Foreign Fighters in Syria and Iraq.” Kosovar Center for Security Studies. <https://qkss.org/en/publikimet/raport-per-shkaqet-dhe-pasojat-e-perfshierjes-se-qytetareve-te-kosoves-si-luftetare-te-huaj-ne-siri-dhe-irak>

13 Kraja, Garentina. 2017. “The Islamic State Narrative in Kosovo, deconstructed one story at a time.” Kosovar Center for Security Studies. <https://qkss.org/en/publikimet/the-islamic-state-narrative-in-kosovo-deconstruct>

propagandën e Shtetit Islamik në rrjete sociale, Kosova paraqitet si një vend ku identiteti fetar mysliman shtypet në emër të shtetit sekular dhe bartësit e saj shtetëror dhe institucional vihen në shërbim të kauzave që identifikohen me shtetet e krishtera perëndimore.

Rreziku nga Shtetit Islamik në Kosovë është zvogëluar ndër vite krahas angazhimit institucional për ta adresuar këtë sfidë të sigurisë përmes rendit dhe ligjit dhe investimit në ngritjen e kapaciteteve komunale e sociale, programeve të ndryshme të dizajnuara dhe të udhëhequra nga shoqëria civile që kontribuan në përmirësimin e kushteve individuale dhe kolektive dhe vetëdijësimin për rrezikun që ky fenomen paraqet për Kosovën dhe qytetarët e saj.¹⁴

Autoritetet e Kosovës e kanë vepruar me forcën e ligjit ndaj luftëtarëve të huaj. Në një operacion të shtrirë në mbarë Kosovën në vitin 2014, autoritetet kanë arrestuar 80 individë, të cilët dyshohet se e kanë financuar dhe mbështetur Shtetin Islamik në Kosovë dhe në emër të kësaj organizate i kanë rekrutuar 255 luftëtarë të huaj nga Kosova. Këta pjesëtarë të grupeve terroriste mendohet se udhëtuan drejt Sirisë dhe Irakut së bashku me 148 anëtarë të tyre të familjes. Llogaritet se rreth shtetas të Kosovës të rekrutuar përmes kauzës së Shtetit Islamik janë vrarë në Siri dhe Irak. Në Kosovë janë kthyer gjithsej mbi 140 luftëtarë të huaj dhe ndërkohë Kosova¹⁵ është bërë ndër shtetet e rralla evropiane që është angazhuar t'i kthejë dhe pranojë qytetarët e saj të riatdhesuar nga këto vatra të luftës.¹⁶

Shumica e të kthyerve me të ardhur në Kosovë janë arrestuar dhe i janë nënshtruar proceseve gjyqësore kundër tyre. Një pjesë e tyre tashmë e kanë vuajtur dënimin në burg, por duke marrë parasysh nivelin e rrezikshmërisë që këta individë dhe kauza të cilën ata e përkrahën paraqet për sigurinë kombëtare të Kosovës dhe aleatëve të saj, institucionet e Kosovës obligohen që të monitorojnë procesin e ndjeshëm të rehabilitimit të tyre dhe rikthimit në komunitet.¹⁷

Krahas operacioneve të policisë, institucionet e Kosovës e kanë aprovuar ligjin kundër pjesëmarrjes në lufta të huaja dhe Kosova është bërë pjesë e Koalicionit Ndërkombëtar kundër Terrorizmit nën udhëheqjen e Shteteve të Bashkuara të

[ed-one-story-at-a-time](#)

14 Qehaja, Florian et al. 2017. "Mapping the State of Play of Institutional and Community Involvement in Countering Violent Extremism in Kosovo," Kosovar Center for Security Studies. <https://qkss.org/en/publikimet/mapping-the-state-of-play-of-institutional-and-community-involvement-in-countering-violent-extremism-in-kosovo>

15 Kosovar Center for Security Studies database, 2023

16 Coleman, Julie and Teuta Avdimetaj, 2021. "Kosovo's Experience in Repatriating Former Fighters," Policy brief. International Centre for Counter-Terrorism, <https://www.icct.nl/publication/kosovos-experience-repatriating-former-foreign-fighters>

17 Perteshi, Skender. 2018. "Beyond Triggers: New Threats of Violent Extremism in Kosovo," Kosovar Center for Security Studies. https://qkss.org/images/uploads/files/violent-extremism-eng_611603.pdf

Amerikës. Ato poashtu kanë mbyllur 16 organizata joqeveritare për veprimtari ilegale që ndërlidhen me aktivitet kundër rendit kushtetues të Kosovës.¹⁸

Megjithatë, rrethanat të cilat e mundësuan radikalizimin dhe ekstremizmin e dhunshëm në Kosovë dhe e shndërruan Kosovën në terren të favorshëm për këto ideologji, vazhdojnë të jenë të pranishme. Përkundër vetëdijësimit shoqëror për rrezikshmërinë e ekstremizmit të dhunshëm, Kosova vazhdon të sfidohet nga probleme të shumta ekonomike, mundësi të kufizuara shkollimi e punësimi, polarizim të thellë, mirëqenie joadekuate dhe infrastrukturë të brishtë institucionale. Për më shumë, komunitetet ku pritet të rikthehen këta pjesëtarë të dikurshëm të Shtetit Islamik shpeshherë janë skeptike dhe refuzuese ndaj tyre, duke krijuar rrethana të pafavorshme dhe stigmatizuese të cilat mund të çojnë në radikalizimin e vazhdueshëm të këtyre individëve.¹⁹ Kjo çështje merr dimension urgjent në veçanti në rastin e fëmijëve të kthyer nga vatrat e konfliktit ku i janë ekspozuar Shtetit Islamik dhe dogmës së tyre. Institucionet e Kosovës dhe organizatat e ndryshme kanë punuar me këtë kategori dhe shumica e tyre tashmë janë duke e ndjekur mësimin e rregullt në shkollat publike të vendit krahas mosharatëve të tyre.²⁰

Ndonëse reagimi i Kosovës për ndalimin e individëve të radikalizuar ishte i pakompromis, institucionet e Kosovës nuk kanë arritur të hartojnë strategji për rehabilitimin dhe reintegrimin e luftëtarëve të huaj dhe familjeve të tyre. Përkundër faktit që institucionet e Kosovës kanë hartuar plan konkret për të punuar me komunitetin që të ndihmojë në rehabilitimin e këtyre individëve, mungesa e kapaciteteve në nivelin lokal si dhe mungesa e koordinimit ndërmjet nivelit lokal dhe qendror në përpjekjet për rehabilitim dhe reintegrim po e pamundëson adresimin e nevojave të këtyre individëve duke rrezikuar që ata sërish t'iu drejtohen për ndihmë adresavë të mëparshme.²¹

Në këto rrethana, kthimi i një numri të konsiderueshëm të individëve të radikalizuar dhe ekstremistëve të dhunshëm si dhe atyre që i janë ekspozuar ideologjive ekstremiste në Kosovë përbënë një sfidë akute dhe afatgjatë për institucionet e sigurisë të Kosovës, të cilat e kanë një mision të dyfishtë – atë të parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm dhe rehabilitimit nga ekstremizmi i dhunshëm.

Ndonëse ekstremizmi i dhunshëm islamist ka qenë për një kohë më të gjatë në fokus të institucioneve të Kosovës për shkak të natyrës së përfshirjes së shtetasve të Kosovës dhe rrezikshmërisë që kjo organizatë terroriste me shtrirje globale kishte për sigurinë kombëtare të Kosovës dhe aleatëve të saj, Kosova

18 Ilazi, R et al. 2022. "Online and offline (de)radicalization in the Balkans, Working Paper 5." PAVE Project Publications. https://www.pave-project.eu/publications/PAVE_870769_D5.1_publication_layout.pdf

19 Kelmendi, Vese. 2018. "Kosovo Security Barometer, Special Edition: Citizens Perception and Community Response on Returned Foreign Fighters," Kosovar Center for Security Studies.

20 Nga shenimet personale te Perteshit, 2023.

21 Interviste me zyrtar të lartë nga Komuna e Prizrenit. 21 Shkurt 2022.

sikur edhe vende të tjera në Evropë dhe gjetiu është e rrezikuar edhe nga lloje dhe forma të tjera të ekstremizmit të dhunshëm.

Ekstremizmi djathtist ka një histori të gjatë në Kosovë. Ndonëse shteti nuk është strehë e grupeve djathtiste ekstreme, kontestimi që Serbia i bën pavarësisë së Kosoëvs dhe shtetësisë së saj përbëjnë pjesën qendrore të ideologjisë së këtyre grupeve, të cilat kanë shtrirje rajonale dhe së fundi edhe globale.²² Sfida e menjëhershme për sigurinë kombëtare të Kosovës është narracioni dhe ideologjia e përbashkët që këto grupe djathtiste ekstreme e kanë me akterët politik në skenën politike të Serbisë dhe Rusisë²³ dhe me kishat nacionale ortodokse të të dyja vendeve slave që e konsideron këtë garë rreth Kosovës si betejë qenësore ideologjike. Narracioni djathtist ekstrem në tërësinë e tij e përshkruan kontestin rreth Kosovës bazuar në terminologjinë e teorisë së “përplasjes së civilizimeve” mes fesë islame dhe krishterimit ortodoks dhe e portretizon Kosovën si “Jerusalemi e Serbisë”.

Grupet djathtiste ekstreme me lidhje dhe ideologji të tilla kanë qenë të pranishme në rajon dhe në Kosovës që nga luftat e viteve të 90-ta në ish-Jugosllavi, por ato kanë rikthyer dhe kanë fituar një momentum të ri përmes mbështetjes së Rusisë që nga aneksimi i Krimesë në vitin 2014. Rusia përmes zgjerimit dhe rekalibrimit të ndikimit malinj në Ballkanin Perëndimor për t’i penguar përpjekjet e rajonit për anëtarësim në NATO dhe Bashkim Evropian, i ka fuqizuar këto grupe dhe ka shfrytëzuar narracionet anti-perëndimore rreth intervenimit ushtarak të NATO-s në vitin 1999 për të ndalur fushatën e Serbisë për spastrim etnik të Kosovës. Grupet si Ujqit e Natës, të cilat kanë lidhje direkte me Presidentin rus Putin, janë të pranishme në Bosnjë dhe janë shtrirë deri në pjesën veriore të Kosovës, ku institucionet shtetërore vazhdimisht janë sfiduar.

Që nga invazioni i Rusisë në Ukrainë në vitin 2022, organizatat djathtiste ekstremiste janë bërë më relevante. Ato janë lidhur me njëra tjetrën, kanë kandiduar në procese zgjedhore në Serbi dhe janë pjesë e institucioneve publike në Republikën Serbe në Bosnjë dhe mbase edhe në Kosovë.

Këto organizata dyshohet se kanë lidhje me krimin e organizuar dhe korrupsionin²⁴ dhe janë bërë platforma rekrutimi për mercenarë dhe rekrutë serbë nga tërë Ballkani për të luftuar në anën e rusëve në Ukrainë. Organizatat djathtiste ekstremiste janë veçanërisht aktive në mediat sociale dhe shpeshherë fuqizohen nga mediat ruse dhe pro-ruse të cilat publikohen në Serbi dhe që amplifikojnë propagandën ruse dhe serbe si dhe përhapin dezinformata që u servohen komuniteteve serbe në mbarë rajonin.

22 Tika, Vera. “Kosovo Issue has Expanded Far Right’s Global Reach,” Balkan Insight, Oct.19, 2022. <https://balkaninsight.com/2022/10/19/kosovo-issue-has-expanded-serbian-far-rights-global-reach/>

23 Ibid.

24 Ibid.

Ndër grupet që duhet veçuar është formacioni paramilitar rus Wagner, i cili tashmë ka zyre të hapur në Serbi dhe që supozohet se ka lidhje të ngushta me liderët kryesor serbë, përfshirë ata që drejtojnë komunitetin e inteligjencës.²⁵ Autoritetet kosovare së fundi kanë paralajmëruar për praninë e Wagnerit në pjesën veriore të vendit, e cila është bërë skenë e tensioneve të ngritur përgjatë tërë vitit 2022.²⁶

NË VIJIM SJELLIM TIPOLOGJITË E EKSTREMIZMIT DHE DEFINICIONET E TYRE:

Ekstremizmi i dhunshëm - Organizata e Kombeve të Bashkuara nuk e ka një definicion të përbashkët dhe të vetëm për ekstremizmin e dhunshëm.²⁷ Ky definicion shpeshherë përdoret krahas terrorizmit, ndonëse së fundi ekstremizmi i dhunshëm kuptohet si një manifestim i dhunës me bazë ideologjike. Organizatat dhe individët që përqafojnë ekstremizmin e dhunshëm si doktrinë të tyre nxisin urrejtje religjioze, i thellojnë ndasitë ideologjike, politike e etnike për t'i legjitimuar veprimet e tyre dhe për t'i arsyetuar qëllimet e tyre.²⁸

Shtetet e Bashkuara të Amerikës e definojnë vet ekstremizmin si ideologji që ka për qëllim rrënimin e vlerave të demokracisë dhe imponimin e një rendi totalitar. Ato e konsiderojnë ekstremizmin si problem politik dhe ideologjik.

Byroja Federale amerikane e Hetimeve (FBI) e definin ekstremizmin e dhunshëm si ndërmarrje apo përkrahje të veprimeve që "janë të motivuara ideologjikisht apo që arsyetojnë përdorimin e dhunës për përmbushjen e qëllimeve shoqërore, ekonomike apo politike."²⁹

Këshilli i Evropës e definin ekstremizmin e dhunshëm si "sjellje e cila e promovon, mbështetë dhe kryen veprime të cilat mund të çojnë në terrorizëm dhe të cilat kanë për qëllim të mbrojnë një ideologji të caktuar përmes promovimit të supremacisë racore, nacionale, etnike apo religjioze" si dhe kundërshtimin e

25 "Pro-Ukrainian activists in Serbia file criminal complaint against Wagner group," **Reuters**, Jan. 19, 2023, <https://www.reuters.com/world/europe/pro-ukrainian-activists-serbia-file-criminal-complaint-against-wagner-group-2023-01-19/>

26 Squires, Nick, "Wagner mercenaries helping Serbia prepare potential attack on our nation, Kosovan president warns," **The Telegraph**, Feb. 11, 2023 <https://www.telegraph.co.uk/world-news/2023/02/11/wagner-mercenaries-helping-serbia-prepare-potential-attack-nation/>

27 Për më shumë informacion, shih diskutimin e Zyres së OKB-së për Narkotikë dhe Krim mbi mungesën e koncensusit për definicionin të përbashkët të terrorizmit <https://www.unodc.org/e4j/en/terrorism/module-4/key-issues/defining-terrorism.html> dhe diskutimin mbi mungesën e koncensusit për definicionin universal për ekstremizmin e dhunshëm <https://www.unodc.org/e4j/zh/terrorism/module-2/key-issues/radicalization-violent-extremism.html>

28 Ibid.

29 Ibid.

vlerave dhe parimeve demokratike.³⁰ Ndërkohë, Këshilli i Evropës e konsideron radikalizimin si proces përmes të cilit individit pranon dhe përkrahë ekstremizmin e dhunshëm.³¹

Ekstremizmi religjioz – përdorimi i ideve dhe shpjegimeve fetare për t'i arsyetuar veprimet e dhunshme të një grupi apo organizate. Ekstremistët fetarë përkrahin interpretime fetare që arsyetojnë përdorimin e dhunës në shërbim të fesë ndaj atyre që i konsiderojnë rivalë fetarë, kryesisht të përbërë nga jobesimtarët ose besimtarët e feve tjera. Për shembull, grupe terroriste si Shteti Islamik e kanë përdorur dhe interpretuar konceptin e "xihadit" për t'iu shërbyer interesave të tyre politike dhe ideologjike.

Në kontekstin e sotëm ekstremizmi religjioz zakonisht i referohet ekstremizmit islamist. Studiuesit e Qendrës për Dialog Strategjik³² me seli në Londër e kanë ndarë ekstremizmin islamist në katër grupe: 1) Islamizmi legalist, ku bëjnë pjesë aktivistë politikë që synojnë ta ndryshojnë shoqërinë sistematikisht dhe gradualisht ta zëvendësojnë rendin qeverisës me shtet totalitar islamik por që nuk janë për përdorim të dhunës për arritjen e qëllimeve të tyre; 2) Islamizmi revolucionar i predikuar nga lëvizja islamiste Hizb ut-Tahrir që për qëllim ka themelimin e kalifatit islamik me sistem totalitar dhe natyrë ekspansioniste që pretendon se të gjithë myslimanët duhet të bashkohen në një shtet të vetëm përfshirë përmes aneksimit të shteteve ekzistuese, 3) Salafizmi politik ku bëjnë pjesë ata që aktivisht punojnë për transformimin politik të shoqërisë në shtet totalitar islamist në bazë të interpretimit të tyre tejet konservativ të fesë myslimane, dhe 4) Islamistët shi-itë, që janë përkrahës të regjimit Iranian.

Ekstremizmi nationalist apo ultranacionalizmi – formë ekstreme e nacionalizmit përmes të cilit një grup njerëzish me veçori të përbashkëta nacionale arsyetojnë përdorimin e dhunës dhe forcës për të shtypur grupe të tjera etnike. Ky ekstremizëm ushtrohet kryesisht duke i nxitur ndasitë dhe urrejtjen racore, etnike dhe religjioze dhe kryesisht manifestohet ndaj komuniteteve etnike dhe emigrantëve, të cilët shpesh bëhet fajtorët kujdestarë për dështimet ekonomike e sociale brenda një shteti.³³

E djathta ekstreme – i ka rrënjët në lëvizjet fashiste dhe naziste të shekullit 20. Shpeshherë ekstremi i djathtë manifestohet si lëvizje politike anti-demokratike që e përkrahë përdorimin e dhunës si formë legjitime për arritjen e qëllimeve dhe politikave ekstreme të djathta.³⁴ Në disa kontekste, e djathta ekstreme është

30 Këshilli i Evropës. 2016. "Handbook for Prisons and Probation Services Regarding Radicalization and Violent Extremism." <https://rm.coe.int/16806f9aa9>

31 Ibid.

32 Për diskutim të detajuar të këtij fenomeni, shih Center for Strategic Dialogue, <https://www.isdglobal.org/extremism/islamism/>, last accessed Feb. 21, 2023

33 Për njohuri bazike mbi nacionalizmin ekstrem, shih Encyclopedia Britannica <https://www.britannica.com/topic/fascism/Extreme-nationalism>

34 Jupskås, Anders Ravik and Iris Beau Segers. 2020. "What is Right-wing Extremism?" Center for Re-

koncept racor, përkrahësit e të cilës besojnë në superioritetin e racës së bardhë. Në raste të tjera përkrahësit e saj janë anti-semitë, ksenofobë, autoritarë dhe besimtarë të teorive të konspiracionit që kanë për qëllim dobësimin e rolit të shtetit demokratik.^{35 36}

E majta ekstreme – e inspiruar nga idelogjitë e majta marksiste, grupet e ekstremit të majtë ishin kryesisht veçori e Luftës së Ftohtë mes Perëndimit dhe Bashkimit Sovjetik. Qëndrimet politike të së majtës ekstreme janë në esencë anti-kapitaliste, anarkiste, pro-komuniste dhe grupet e ashtuquajtura “anti-fa,” që është shkurtesë për qëndrime “anti-fashiste”.³⁷ Sikur grupet e të djathës ekstreme, edhe grupet e majta ekstreme e përdorin petkun ideologjik për ta arsyetuar dhunën si mjet për arritjen e qëllimeve politike. Dyja këto ekstreme e konsiderojnë shtetin të paaftë për t’i adresuar dhe përmbushur bindjet e tyre ideologjike.

Organizatrat terroriste si “Al Fateh al Sham” apo “Shteti Islamik” i kanë joshur përkrahësit e tyre në Kosovë përmes një togëzimi të islamizmit legalist, islamizmit revolucionar të predikuar nga ideologjia takfiriste dhe salafizmit politik. Për disa vite gjatë periudhës së rekrutimit me propagandës intenzive, Shteti Islamik ka thirrur për krijimin e “Kalifatit” përmes një narracioni të ndërtuar mbi debatet e brendshme sikur kontestimi për ndërtimin e xhamisë në qendër të Prishtinës apo kritikata ndaj institucioneve të Kosovës dhe partnerët e tyre ndërkombëtar si të paftë për t’i realizuar premtimet që ta shndërrojnë Kosovë në vend të përparuar. Institucionet e vendit paraqiten si të korruptuara dhe tërësisht të varura nga aleancat e tyre perëndimor. Njëkohësisht ky grup e paraqiste luftën e “Shtetit Islamik” si pjesë të betejë më të gjerë globale dhe në atë narracion shqiptarët e Kosovës portretizoheshin si pjesë e komunitetit global myslimanë që jetojnë përbrenda një sferë politike të bashkuar, të mbrojtur nga kanosjet e radhës ndaj identitetit të tyre fetar.³⁸

search on Extremism, University of Oslo. <https://www.sv.uio.no/c-rex/english/groups/compendium/what-is-right-wing-extremism.html>

35 Për një diskutim më gjithpërfshirës të ideologjive ekstreme djathtiste dhe manifestimin e tyre, shih Encyclopedia Britannica, përfshirë fenomenin e fajësimit të të tjerëve, seksizmit dhe mizogjinisë <https://www.britannica.com/topic/fascism/Extreme-nationalism>

36 Dokumentet analitike të Bashkimit Evropian e definojnë ekstremizmin djathtist si “akte individuale apo grupe të cilat nxisin, kërcënojnë, legjitimojnë apo e përkrahin dhunën dhe urrejtje për t’i çuar tutje qëllimet e tyre ideologjike apo politike bazuar në refuzimin e rendit demokratik dhe vlerave, përfshirë të drejtat themelore, dhe përqëndrohen në nacionalizëm përjashtues, racizëm, ksenofobi dhe mostolerim.” (Shih për shembull https://home-affairs.ec.europa.eu/whats-new/publications/violent-right-wing-extremism-western-balkans-july-2022_en)

37 Për diskutim më të thuktë dhe më të nuancuar mbi partitë e krahut të së majtës ekstreme dhe agjendën e tyre bashkëkohor në Evropë, shih artikullin e Luke March “Contemporary Far Left Parties in Europe: From Marxism to Mainstream?” të botuar nga Friedrich Ebert Stiftung, 2008. <https://library.fes.de/pdf-files/id/ipa/05818.pdf>

38 Diskutimi i pikave kryesore të narracionit të ISIS në Kosovë mund të gjehen në raportin e Garentina Krajës, të vitit 2017 “The Islamic State Narrative in Kosovo, deconstructed one story at a time.” Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. <https://qkss.org/en/publikimet/the-islamic-state-narrative-in-kosovo-deconstructed-one-story-at-a-time>

Krahas kërcënimit të shprehur islamist, siguria kombëtare e Kosovës viteve të fundit është rrezikuar edhe nga e djathta ekstreme dhe lëvizjet e ngajshme nacionaliste që origjinën e kanë në Serbi dhe Rusi. Këto lëvizje kontestojnë shtetësisë dhe pavarësinë e Kosovës nga Serbia dhe gjejnë mbështetje në strukturat paramilitare dhe institucionale të Serbisë. Pjesëtarët e këtyre lëvizjeve, aktivitetet e të cilave shpeshherë janë të koordinuara dhe të ndërlidhura, kanë shtrirje territoriale në tërë rajonin dhe në veçanti në enklavat serbe ku sfidohet autoriteti i institucioneve vendore.³⁹ Të bashkuara në mision dhe ikonografi, këto grupe dhe pjesëtarët e tyre janë të dhunshëm në mbrojtje të identitetit të krishter ortodoks me rrënjë narracioni në Betejën e Kosovës të vitit 1389. Rreziku nga destabilizimi i Kosovës përmes këtyre grupeve është rritur që nga invazioni i Rusisë në Ukrainë në shkurt të vitit 2022 duke marrë parasysh keqpërdorimin e shembullit të Kosovës për ta arsyetuar pushtimin rus nga zyrtarët më të lartë shtetëror të Rusisë si dhe spekulimet për bashkangjijtjen e vullnetarëve serbë si luftëtarë të huaj në frontin rus në Ukrainë.⁴⁰ Së fundi, prania e grupit famëkeq rus Ēagner në rajon krahas lidhjeve të afërta me organizatat ekstremiste të djathta serbe përbënë edhe një shqetësim të menjëhershëm për sigurinë e Kosovës e cila tashmë është shndërruar në cak të projektimit të fuqisë ruse në Ballkanin Perëndimor.⁴¹

39 Tika, Vera. "Kosovo Issue has Expanded Far Right's Global Reach," Balkan Insight, Oct.19, 2022. <https://balkaninsight.com/2022/10/19/kosovo-issue-has-expanded-serbian-far-rights-global-reach/>

40 McGlynn, Jade, "Why Putin Keeps Talking about Kosovo," Foreign Policy, March 3, 2022. <https://foreign-policy.com/2022/03/03/putin-ukraine-russia-nato-kosovo/>

41 Komarcevic, Dusan. "Serbian Right-Winger Says Vagner Ties Could Help If There's 'Conflict In Kosovo,'" Radio Free Europe, Dec. 6, 2022 <https://www.rferl.org/a/serbia-russia-vagner-kosovo-ultranationalists-/32164146.html>

2. SHITJELLIM DHE PËRMBLEDHJE E PRAKTIKAVE MË TË MIRA NDËRKOMBËTARE QË APLIKOHEN SOT NËPËR SHITETET EVROPIANE NGA SHËRBIMET SPROVUESE NË KUADËR TË PROGRAMEVE REHABILITUES DHE REINTEGRUESE

Ndonëse secili shtet i ka politika e vet të sigurisë të ndërtuara në bazë të vlerësimit individual të rrezikshmërisë së "luftëtarëve të huaj" të kthyer në vendet e origjinës, apo popullatës që i është ekspozuar ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit, ky doracak në vazhdim do të përfshijë një sërë parimesh të nxjerra nga praktikatat më të mira globale, të përzgjedhura për kontekstin e Kosovës, me qëllim të informimit të politikave dhe vendimeve të Shërbimit Sprovues të Kosovës gjatë procesit të rehabilitimit dhe reintegrimit të këtyre individëve. Qëllim eksplicit i kësaj përmbledhje është që ajo të shërbejë si një udhërrëfyes për Shërbimin Sprovues të Kosovës, por jo të zëvendësojë përvojën dhe njohurinë praktike të zyrtarëve të saj për t'iu përshtatur rrethanave dhe resurseve të Kosovës dhe këtij grupit të cenueshëm të individëve. Në veçanti, kjo përmbledhje praktikash synon që të lehtësojë punën e zyrtarëve të SHSK-së gjatë përbaljes me të mitur dhe me gra, duke siguruar një qasje me ndjeshmëri gjinore dhe që e ka parasysht traumën nëpër të cilën kanë kaluar këta individë.

Qendra për parandalimin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm Hedaya, e cila mbështetet nga qeveria e Emirateve të Bashkuara Arabe dhe vende tjera perëndimore dhe është ndër mekanizmat kryesor në studimin dhe luftimin e këtij fenomeni, i ka hartuar 143 parime për rehabilitimin dhe reintegrimin e luftëtarëve të huaj të organizatave terroriste me agjendë islamiste në mbarë botën të cilët janë kthyer në vendet e origjinës pas pjesëmarrjes në vatrat e luftës në Lindjen të Mesme.⁴² Në vijim po i sjellim ato që janë të rëndësishme për kontekstin e Kosovës.

Së pari, autoritetet duhet të sigurohen që të gjitha programet që kanë për synim reintegrimin dhe rehabilitimin e luftëtarëve të huaj të respektojnë parimet e ligjit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut dhe të përputhen me rregullat për trajtimin

42 Blueprint of a Rehabilitation and Reintegration Center, "Guiding Principles for Rehabilitating and Re-integrating Returning Foreign Terrorist Fighters and their Family members." Hedaya Center, 2020. https://hedayah.com/app/uploads/2021/09/Final-Version_Blueprint-of-a-Rehabilitation-and-Reintegration-Center_FullVersion.pdf

e të burgosurve. Në aspektin gjinor, grave që janë nën mbikqyrjen e shërbimeve sprovuese, duhet t'iu mundësohet përkujdesja për fëmijë, t'iu mundësohet hapësira dhe resurset për përkujdesje dhe higjienë personale. Kontrolli fizik i tyre të bëhet nga nëpunëset gra (parimi 1).⁴³

Një parim tjetër është që çdo etapë e hartimit të politikave të përfshijë konsultimin me shoqërinë civile dhe t'ia mundësojë shoqërisë civile monitorimin e zbatimit të programeve në mënyrë që të identifikohen shpejt sfidat e implementimit (parimi 10).⁴⁴ Një praktikë e tillë duhet të themelohet dhe forcohet edhe nga ana e SHSK gjatë hartimit të politikave të tyre të rehabilitimit dhe reintegrimit apo politikave të ndryshme institucionale të ShSK-së.

Autoritetet duhet të sigurohen që ambienti në të cilin ndodhë reintegrimi është i sigurtë për klientin e tyre. Shpeshherë ish luftëtarët e huaj përballen me kërcënime nga rrethi për shkak të të aktivitetit të tyre të mëparshëm, por edhe për shkak të bashkëpunimit me autoritete. Andaj, është me rëndësi që institucionet dhe nëpunësit e tyre të krijojnë ambient të sigurtë për të kthyerin në komunitet (parimi 12).⁴⁵ Në këtë aspekt, është e rëndësishme që SHSK-së të rritë bashkëpunimin me komunitetin lokal si dhe OJQ-të që veprojnë në nivel lokal, veprim që do të ndikonte edhe në qëndrueshmërinë e këtyre proceseve.

Një parim tjetër ka të bëjë me ofrimin e shpërblimeve dhe dënimeve si inkurajim dhe nxitje për t'iu nënshtruar procesit të rehabilitimit. Këto shpërblime dhe dënime duhet të komunikohen qartazi dhe të aplikohen në mënyrë konsistente. Hedaya për ilustrim e ofron Kodin e ndalimit të Gjeorgjisë i cili ofron një sërë masash inkurajuese përfshirë anulimin e masës disiplinore, vizitë familjes, shtimin e ndonjë vizite apo telefonate familjes dhe të afërmëve të tjerë (parimi 18).⁴⁶

Për të pasur sukses në procesin e rehabilitimit dhe reintegrimit, është e preferueshme që autoritetet të jenë në dijeni përmes hulumtimeve dhe analizave për nevojat e klientëve të tyre dhe kontekstin e tyre shoqëror, kulturor dhe ekonomik, meqë një analizë e tillë do t'ua mundësojë autoriteteve të përgatisin masa adekuate që u përgjigjen atyre nevojave dhe që e lehtësojnë procesin e rehabilitimit e reintegrimit (parimi 20).⁴⁷ Është shumë e rëndësishme që SHSK të pajiset me informata dhe analiza nga SHKK dhe MPB lidhur me shkaktarët shtytës të radikalizmit për të dënuarit për terrorizëm. Institucionet tjera duhet të ndajnë më SHSK raportet e monitorimit për të dënuarit për terrorizëm në mënyrë që SHSK të ketë mundësi të hartojë analiza dhe raporte të rregullta për të dënuarit për terrorizëm dhe ekstremizëm të dhunshëm.

43 Ibid, p. 22

44 Ibid, p. 37

45 Ibid, p. 40

46 Ibid, p. 43

47 Ibid, p. 46

Të miturit të trajtohen veçmas nga të rriturit nën mbikqyrjen e shërbimeve korrektuese dhe sprovuese, në veçanti përmes programeve që e adresojnë stigmatizimin dhe izolimin nga rrethi (parimi 24).⁴⁸

Në rastet kur e tërë familja është e radikalizuar, t'u jepet mundësi të miturve që të punohet me ta ndaras në mënyrë që ata mos të jenë vazhdimisht në ndikimin e anëtarëve të tjerë të radikalizuar të familjes. Njëkohësisht është mirë që i njëjti nëpunës ta mbikqyrë secilin anëtar të familjes për ta njohur kontekstin dhe përparimin e tyre drejt rehabilitimit. Megjithatë në rastin e nënave dhe foshnjëve dhe fëmijëve të vegjël, ata duhet të qëndrojnë bashkarisht (parimi 25).⁴⁹

Parimi 26⁵⁰ thërret për një bashkëpunim të të gjitha institucioneve shtetërore, përfshirë ato në nivelin komunal dhe lokal, sikur punëtorët shëndetësorë, mësuesit, figurat religjioze, për t'u koordinuar bashkarisht dhe për të diskutuar mes vete për secilin rast të paktën një herë në javë. Këto takime mbahen pa praninë e policisë dhe organeve të rendit.

Një koordinim i thukët dhe shkëmbim informacioni në secilin nivel përmes një mekanizmi të përbashkët është kusht për suksesin e programeve të rehabilitimit dhe reintegrimit (parimi 28).⁵¹

Të punohet me komunitetin paraprakisht që të jetë i gatshëm t'i pranojë ish luftëtarët e huaj dhe familjet e tyre në mesin e tij (parimi 33).⁵²

Stafi duhet të jetë i trajnuar që t'i shoh ish luftëtarët e huaj si individë të cilët janë duke u përpjekur të rehabilitohen dhe nëpunësit institucionalë duhet të përkujdesën për krijimin e një ambienti përkrahës që nuk i stigmatizon këta individë. Njëkohësisht, stafi duhet të jetë mirë i trajnuar që t'iu rezistojë manipulimeve ideologjike dhe korruptive nga klientët. Është jashtëzakonisht e rëndësishme që stafi të ketë në përbërje gra të cilat ekskluzivisht do të merren me gratë e kthyer nga vatrata e konfliktit (parimi 44 dhe 45).⁵³

Krahas nëpunësve sprovues, rekomandohet që institucionet të angazhojnë psikologë ose këshilltarë psiko-social, punëtorë social, trajnues për zejtarë, instruktorë arti, udhëheqës fetarë, ndërlidhës me komunitetin, profesionistë shëndetësorë. Pjesë e këtij ekipi me ish luftëtarët e huaj mund të jenë edhe ish luftëtarë të rehabilituar të cilët mund ta ndajnë përvojën e tyre personale (parimi 47).⁵⁴ Hedaya sjellë shembullin e Singapurit, shtet i cili me sukses e ka bërë

48 Ibid, p. 53

49 Ibid, p. 55

50 Ibid, p. 56

51 Ibid, p. 60

52 Ibid, p. 65

53 Ibid, p. 82-83

54 Ibid, p. 85

reintegrimit dhe rehabilitimit të radikalizuarve përmes një grupi vullnetarë të studiuesve dhe mësuesve të respektuar të Islamit, të cilët e kanë adresuar leximin dhe interpretimin e gabueshëm të fesë që ka çuar drejt ekstremizmit të dhunshëm.

Pjesë esenciale e programeve rehabilituese është hartimi i një raporti vlerësues për individët që i nënshtrohen shërbimeve korrektuese dhe sprovuese. Në kuadër të parimeve, Hedaya propozon që institucionet relevante ta bëjnë vlerësimin e secilit individ që i nënshtrohet përkujdesit të tyre, përfshirë edhe si masë për ndërtimin e besimit të individëve ndaj sistemit rehabilitues. Vlerësimi duhet të jetë pjesë e dosjes së secilit individ dhe ai duhet të përfshijë detaje për kushtet e jetës, rrethanat familjare apo ndonjë precedent penal në të kaluarën (parimi 83).⁵⁵ Ky informacion mund të mbledhet nga bisedat me familjarë, por në vlerësimin e Hedayas, preferohet që burim i këtij informacioni parësor të jetë individi që i është nënshtrohet procesit të rehabilitimit përmes një metode në formë të bisedës së hapur dhe joformale e më pak në formë të marrjes në pyetje, siç është praktikë e forcave të rendit dhe ligjit. Hedaya sjellë rastin e Somalisë, ku për individët që dikur ishin pjesëtarë të organizatës famëkeqe al Shabab, qendra rehabilituese kishte mbledhur informacionin për klientët përmes një instrumenti/ankete mbi detajet personale, të dhënat demografike, arsyet shtytëse për t'iu bashkuar organizatës terroriste, si dhe vlerësimet psikosociale, ato të rrezikshmërisë së përgjithshme dhe të pjesëmarrjes në trajnime për aftësim profesional.

Ndërtimi i besimit mes autoriteteve dhe individëve që i janë ekspozuar ekstremizmit të dhunshëm konsiderohet si hallka kryesore në procesin e rehabilitimit të ish luftëtarëve të huaj. Hedaya rekomandon që nëpunësit të komunikojnë hapur dhe me respekt me individët nën mbikqyrjen e tyre, t'i menaxhojnë pritjet dhe të mos bëjnë premtime të cilat nuk mund t'i realizojnë (parimi 85).⁵⁶ Në veçanti është e rëndësishme që nëpunësit të mos komunikojnë me paragjykime me individët nën mbikqyrjen e tyre, por t'iu afrohen atyre me konsideratë dhe me gadishmëri për t'iu ndihmuar në procesin e rehabilitimit dhe në veçanti të jenë të hapur për t'i dëgjuar këta individë edhe atëherë kur nëpunësit nuk pajtohen me bindjet ideologjike të klientëve (parimi 90).⁵⁷

Besimi ndërtohet edhe përmes komunikimit të sinqertë për pritshmëritë e institucionit ndaj individëve nën mbikqyrjen e tyre. Komunikimi i qartë dhe konsistent për rregullat, kufizimet dhe sjelljen është esencial për suksesin e procesit të rehabilitimit, sikur që është edhe qasja e barabartë e individëve karshi realizimit të të drejtave të tyre (parimi 93).⁵⁸ Hedaya rekomandon që të bëhet klasifikimi i individëve që i nënshtrohen procesit të rehabilitimit të paktën

55 Ibid, p. 133

56 Ibid, p. 137

57 Ibid, p. 140

58 Ibid, p. 142

përmes moshës, gjinisë dhe nivelit të rrezikshmërisë (parimi 95)⁵⁹ dhe sjellë si shembull rastin e Holandës, ku individët janë kategorizuar në bazë të pesë kategorive, duke filluar nga të dënuarit për terrorizëm e deri te nxitësit e urrejtjes. Organizata poashtu inkurajon edhe përdorimin e instrumenteve të caktuara për të vlerësuar rrezikshmërinë e klientëve dhe vlerësimin e rregullt të nevojave të tyre (parimi 98 dhe 99).⁶⁰

Nga përvoja e hulumtuesve të Kosovës që i kanë intervistuar grupet e marginalizuara si dhe ato që u janë ekspozuar traumave, mënyra më efektive për të mbledhur të dhëna mbi subjektet e hulumtimit është që të adaptohen metoda të cilat përdoren në disiplinën e historisë gojore, ku subjekti i intervistuar zgjedhë vet se çfarë dëshiron të ndajë me bashkëbiseduesin pa përcjellur ndonjë pyetësor apo agjendë të caktuar. Në këtë formë, subjektit nuk i bëhet presion të flas për traumën pa qenë vet i gatshëm ta bëjë një gjë të tillë dhe njëkohësisht i jepet mundësia që të ndihet në pronësi të rrëfimit të tij, duke i sqaruar shkaqet dhe pasojat e vendimeve të veta nga prizmi personal.

Hedaya vlerëson që çelësi i suksesit të programeve rehabilituese është dizajnimi individual i një plani për secilin pjesëtar që i nënshtrohet një program të tillë dhe në rastet kur është e mundur pjesëmarrja e drejtpërdrejt e tyre në hartimin e planit për t'i nxitur ata që të kenë pronësi dhe përkushtim mbi caqet dhe rrugën drejt realizimit të tyre (parimi 105).⁶¹

Në rastin e grave që i nënshtrohen programeve rehabilituese, udhërrëfyes është Rezoluta 2396 e Këshillit të Sigurimit të OKB-së, e cila bën thirrje për programe rehabilitimi që marrin parasysh aspektin gjinor. Sipas parimit 107⁶² të Hedayas kjo nënkupton shpeshherë trajtim psikosocial që ndihmon përballjen me traumën dhe dhunën me të cilët gratë mund të jenë përballur gjatë përfshirjes së tyre në grupet terroriste. Njëkohësisht, gratë e kthyer nga zonat e konfliktit në Lindje të Mesme shpeshherë janë cak i stigmatizimit nga komuniteti ku rikthehen për shkak të pjesëmarrjes në grupe terroriste apo faktit që janë martuar me ekstremistë të dhunshëm. Komuniteti dhe familja mund t'i përjashtojë ato tërësisht dhe një element i tillë duhet të merret parasysh gjatë dizajnit të planit individual të rehabilitimit, përfshirë edhe mundësinë që në rast të refuzimit gruaja të zhvendoset në një komunitet të tretë.

Ndërkohë, për të miturit është esenciale që ata sa më shpejt t'i kthehen normalitetit, e që në shumicën e rasteve nënkupton shkuarjen në shkollë, bashkangjijtjen në klube të ndryshme sportive por edhe përkujdesin psikologjik për t'i adresuar traumat që u janë shkaktuar këtyre fëmijëve gjatë qëndrimit në

59 Ibid, p. 144

60 Ibid, p. 152

61 Ibid, p. 158

62 Ibid, p. 161

ambientet e kontrolluara nga grupet terroriste (parimi 108).⁶³

Sa i përket planeve rehabilituese, për të siguruar konsistencë është e rekomandueshme që secili individ që i nënshtrohet programit rehabilitues ta ketë një nëpunës – “menaxher të rastit” të dedikuar që e mbikqyrë dhe përcjellë përparimin individual të këtyre ish luftëtarëve të huaj në baza të rregullta (parimi 109).⁶⁴

Për ta bërë përparimin e klientëve të matshëm, planet e personalizuara të rehabilitimit duhet të përmbajnë qëllime të definuara qartazi dhe hapa sado të vegjël të ndryshimit – indikatorë që dëshmojnë që individët kanë filluar ta ndryshojnë qëndrimin e tyre - duhet të regjistrohen. Sipas parimit 114,⁶⁵ për të pasur një program të suksesshëm monitorimi, duhet të bëhet një vlerësim fillestar që përmbledhë të dhënat bazë për gjendjen e klientit para se t’i nënshtrohet programit të rehabilitimit. Ky vlerësim duhet të përdoret për të monitoruar dhe matur çdo ndryshim që ndodhë për shkak të planit rehabilitues dhe mund të shërbejë edhe për përmirësimin e planit të personalizuar përgjatë procesit të rehabilitimit. Për shembull, Hedaya sjellë rastin e ekstremistëve të organizatës famëkeqe Boko Haram, të cilët e kishin ndaluar mësimin e matematikës dhe të gjuhës gjatë aktivitetit të tyre terrorist, por si pjesë të programit të rehabilitimit kishin filluar t’i përvetësojnë me entuziazëm këto lëndë mësimore.

Intervenimet programore për rehabilitimin e ish luftëtarëve të huaj dhe të kthyerve të tjerë nga zonat e konfliktit të kontrolluara nga grupet terroriste janë të ndryshme dhe shpesh varen nga resurset që institucionet i kanë në dispozicion. Këto intervenime mund të jenë këshillimet psikosociale, mentorimi, trajnimet e të menduarit kritik, këshillimet fetare të cilat sfidojnë interpretim religjioz që çon deri te përdorimi i dhunës, pjesëmarrje në sporte, por edhe ligjeratat e ndryshme të cilat e zgjerojnë diapazonin e këtyre individëve qoftë duke përmirësuar komunikimin e tyre qoftë duke u dhënë njohuri të reja të cilat mund t’i aplikojnë në arritjet profesionale në të ardhmen. Për suksesin e këtyre metodave, Hedaya rekomandon përfshirjen e palëve të treta që kanë ekspertizë në këto fusha (parimi 116).⁶⁶ Në rastin e fëmijëve, organizata rekomandon 5 parime që lidhen me promovimin e shëndetit mental dhe mirëqenies, përkrahjes nga familja, shkollës, përkrahjen e komunitetit dhe përmirësim të sigurisë.

Meqë rehabilitimi varet edhe nga faktorë të tjerë që individët nuk mund t’i kontrollojnë plotësisht, është e rëndësishme që institucionet të punojnë më shoqërinë civile dhe autoritetet lokale ta përgatisin komunitetin për rikthimin e ish luftëtarëve të huaj dhe t’i përgatisin individët që i janë nënshtroar rehabilitimit

63 Ibid, p. 162

64 Ibid, p. 166

65 Ibid, p. 170

66 Ibid, p. 181

për disa nga paragjykimet që ekzistojnë në shoqëri dhe komunitet për ta (parimi 120).⁶⁷ Ky proces i ndjeshëm duhet të menaxhohet me kujdes duke pasë parasysh që gabimet gjatë tij mund të zgjojnë ndjenja negative dhe të riaktualizojnë traumat të këta individë. Andaj, është me rëndësi që të investohet në përgatitje paraprake për këtë moment të rikthimit dhe që të krijohen mundësi për komunikim të vazhdueshëm për të krijuar besim të ndërsjellë mes dy palëve. Momenti i reintegrimit nënkupton edhe vazhdimin e ndihmës dhe kontaktit mes institucioneve dhe individëve, përfshirë për programe në të cilat individët mund të inkuadrohen apo vende të punës për të cilët individët mund të kenë ekspertizën e duhur (parimi 125).⁶⁸

Duke marrë parasysh stigmatizimin me të cilin përballen gratë e kthyer nga zonat e kontrolluara nga Shteti Islamik dhe organizatat tjera terroriste, institucionet e Kosovës duhet të gjejnë modalitete bashkëpunimi me organizatat e grave në nivel lokal për të provuar socializimin dhe integrimin e tyre gradual në komunitet. Këto organizata të grave kanë punuar me dekada me gra të mbijetuara të dhunës seksuale gjatë luftës apo viktima të dhunës në familje, dhe ekspertiza e përvoja e tyre me rehabilitimin e këtyre grupeve të marginalizuara do të ndihmojë në resocializimin e kësaj kategorie të grave. Në veçanti, këto organizata ndër vite kanë ofruar “hapësira të sigurta” për gratë që janë viktimizuar që të flasin lirshëm dhe me konfidencialitet të plotë për përvojat e tyre. Pjesëmarrja në këto “hapësira të sigurta” konsiderohet hallkë e cila e ndihmon procesin e reintegrimit të kësaj kategorie. Njëkohësisht, duhet të konsiderohet dhe punohet me organizata të cilat ofrojnë platformë për këta individë që të flasin hapur dhe ta kenë mundësinë që të kërkojnë falje nga komuniteti për veprimet e tyre në kuadër të një procesi të pajtimit dhe dialogut (parimi 131).⁶⁹

Sikur me procesin e rehabilitimit, edhe procesi i reintegrimit duhet të jetë i matshëm. Për vlerësimin e reintegrimit të këtyre individëve duhet të bisedohet me një rreth më të gjerë që përfshinë familjen, punëdhënësin, shoqërinë (parimi 130).⁷⁰ Edhe ky proces rekomandohet të bëhet përmes krijimit të një ambienti që i inkurajon dhe nxitë individët e radikalizuar t’i kontestojnë bindjet e tyre radikale, ideologjinë dhe vendimin për t’i bashkangjitur organizatave terroriste, por pa i konfrontuar dhe qortuar ata në formë të drejtpërdrejt. Poashtu, është esenciale që komunitetit t’i sqarohet roli i rëndësishëm që ka në rehabilitimin dhe reintegrimin e këtyre individëve dhe t’i shpjegohet si mundësi për ta dhënë kontributin e tij në sigurinë e përgjithshme. Në këtë fazë rekomandohet që të punohet intenzivisht me organizatat e shoqërisë civile të cilat shpesh e luajnë

67 Ibid, p. 186

68 Ibid, p. 190

69 Ibid, p. 198

70 Ibid, p. 197

rolin e ndërmjetësuesit mes institucioneve dhe komunitetit (parimi 136).⁷¹

Secila përpjekje për reintegrim duhet të përcillet me një strategji të qartë komunikimi me komunitetin e cila duhet të zbatohet paraprakisht (parimi 139).⁷² Është esenciale që institucionet të komunikojnë me mediat në këtë fazë dhe të punojnë me to duke i informuar për rreziqet e stigmatizimit dhe ndikimit negativ që ky stigmatizim mund të ketë në procesin e rehabilitimit dhe reintegrimit. Poashtu, për një strategji efektive të komunikimit është me rëndësi që individët që kalojnë në procesin e rehabilitimit dhe reintegrimit të jenë pjesë e fushatës vetëdijësuese qoftë përmes rrëfimeve të tyre për këtë përjetim dhe pendimin për t'iu bashkuar kauzave të tilla, ose përmes konfrontimit mes tyre dhe viktimave të veprimeve të tyre (parimi 143).⁷³

Duke i pasur parasysh këto parime, Shërbimi Sprovues i Kosovës ka nevojë të investojë resurse në këto pika:

- Të hartoj një udhëzim për klasifikimin e individëve nën mbikqyrjen e SHSK-së në bazë të vlerësimit të strukturuar të rrezikshmërisë së tyre
- Të krijoj një mekanizmi për vlerësim periodik të individëve para dhe pas intervenimeve programore për të përcjellur ndikimin e intervenimeve të tilla në deradikalizimin e këtyre individëve
- Të bëj dizajnim të intervenimeve programatike varësisht nga nevojat e individëve nën mbikqyrje
- Të ndërtoj ekspertizë për formulimin e projekt-propozimeve për adresim institucioneve relevante të Kosovës dhe partnerëve ndërkombëtar me qëllim të mbështetjes, përfshirë dizajnimin e qëllimeve dhe procesit të intervenimeve
- Trajnime për sjelljen e zyrtarëve të SHSK-së ndaj individëve të radikalizuar, me theks të vecantë te të miturit dhe gratë
- Të bëj standardizim të definicioneve për këtë kategori individësh me institucionet dhe organizatat e shoqërisë civile
- Të bëj sinkronizimin e qëllimeve, planeve dhe programeve mes akterëve përmes takimeve të rregullta mes zyrtarëve të SHSK-së dhe hisedarëve të tjerë

71 Ibid, p. 206

72 Ibid, p. 210

73 Ibid, p. 216

- Shkëmbim të informacionit me institucionet tjera që në formë direkte ose indirekte janë të përfshirë në rehabilitimin, reintegrimin e të radikalizuarve dhe parandalimin ose luftimin e ekstremizmit të dhunshëm
- Krijimi i raportit me familjet dhe komunitetin e të radikalizuarve dhe komunitetin lokal në përgjithësi;
- Krijimin e rrjetizimit dhe kërkimin e ndihmës akterëve jo-institucionalë – liderëve të komunitetit, figurave fetare - në rehabilitim krahas zyrtarëve të SHSK-së
- Ngritja e kapaciteteve të SHSK për komunikim strategjik me media dhe publikun për punën e tyre në përgjithësi, si dhe procesin e rehabilitimit dhe reintegrimit në veçantii;

3. PROCESI I REHABILITIMIT DHE REINTEGRIMIT

Që SHSK-ja të jetë e suksesshme në qëllimin e saj për të rehabilituar dhe riintegruar të kthyerit nga vatrat e krizës në Lindjen të Mesme dhe në minimizimin e recidivizmit dhe kërcënimit që ky grup individësh paraqet për sigurinë kombëtare, krahas identifikimit të karakteristikave individuale dhe kolektive të këtij grupi (sipas Analizës nën 1 dhe parimeve të shtjelluara në pjesën e 2), nevojitet formulimi i praktikave që janë në përputhje me kodin etik të SHSK-së që i respekton të drejtat e individëve që po kalojnë nëpër sistemin sprovues.

Por fillimisht, të definojmë se çfarë nënkuptojmë me rehabilitim dhe reintegrim, si dhe me intervenime programore të cilat janë të nevojshme për ta minimizuar praninë e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit në Kosovë.

3.1 CKA ESHTË REHABILITIMIT DHE RIINTEGRIMI?

Republika e Kosovës është ndër shtetet e rralla që ka vendosur të marrë përgjegjësitë që i takojnë karshi shtetasëve të saj që kanë qenë të involvuar me Shtetin Islamik dhe organizatat të tjera terroriste. Deri në maj të vitit 2019, afërsisht 130 kosovarë janë kthyer nga zonat e luftës. Ndaj tyre janë ndërmarrë procedurat hetimore dhe janë dënuar sipas ligjeve në fuqi. Për më tepër, me mbështetjen e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Qeveria e Kosovës, në maj të vitit 2019 i riadhesoi edhe 110 qytetarë të Kosovës nga kampet e refugjatëve në Siri dhe Irak. Prej të kthyerve, 4 ishin luftëtarë të huaj, e të tjerët ishin gra dhe fëmijë. Poashtu, në korrik të vitit 2021 Kosova riadhesoi edhe 11 qytetarë të saj nga zonat e konfliktit. Që nga viti 2011 kur shpërtheu konflikti në këto zona e deri më tani, në Kosovë janë riadhesuar nga Siria dhe Iraku mbi 250 qytetarë të saj.

Sipas të dhënave të SHSK-së, nën mbikqyrjen e këtij institucioni në dhjetor të vitit 2022 janë gjithsej 82 individë, prej të cilëve 28 të liruar me kusht të gjinisë mashkullore, të cilët janë trajtuar për veprat penale të terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, dhe 28 gra të dënuara me kusht për veprat penale të terrorizmit, ekstremizmit të dhunshëm dhe pjesëmarrje në lufta të huaja.

Duke marrë parasysh natyrën e rëndë të veprës penale dhe rrezikshmërinë që kjo veprimtari e inspiruar nga ideologjia ekstremiste bartë për sigurinë nacionale të shteteve ku ky fenomen është i pranishëm, është e domosdoshme që individët që e kanë përçafuar ekstremizmin e dhunshëm apo që i janë ekspozuar atij t'i ndështrohen një mbikqyrje dhe përkujdesi institucional që minimizon mundësitë e recidivizmit në këto raste. Ky përkujdesi institucional dhe mbikqyrje bëhet për qëllim të rehabilitimit dhe reintegrimit përmes programeve dhe ndërhyrjeve apo

të ashtuquajturave “intervenime” specifike.

Në kontekstin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit, programet e rehabilitimit dhe reintegrimit synojnë t'i adresojnë shkaktarët që i kanë joshur shtetasit e një vendi t'i bashkohen kauzave dhe organizatave terroriste dhe të punojnë me individët për t'i konfrontuar bindjet e tyre ideologjike dhe të dhunshme pasi të kenë kaluar nëpër sistemin e drejtësisë dhe të kenë vuajtur dënimin për veprën penale. Qëllimi kryesor i këtyre programeve është që këta individë të rikthehen në shoqëri si të deradikalizuar, të distancuar nga ideologjia që e kishte frymëzuar radikalizimin e tyre dhe rreshtimin në organizata terroriste e kauza ekstremiste, dhe për të minimizuar rrezikun e recidivizmit të tyre.

Sipas Këshillit të Evropës, qëllimi i intervenimeve pëmes të ashtuquajturave “programe të targetuara” të cilave u nënshtrohen individët që i janë ekspozuar ekstremizmit të dhunshëm apo e kanë përqafuar atë ideologji, është të largojnë individët nga kjo kauzë, pra të punojnë në distancimin e tyre nga grupet terroriste e ekstremiste dhe ta bëjnë deradikalizimin e tyre, pra të ndryshojnë bindjet e tyre ideologjike.⁷⁴

Në kontekstin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë e ka definuar rehabilitimi dhe reintegrimin si proces përmes të cilit individët që kanë marrë pjesë në organizata ekstremiste apo e kanë përkrahur ideologjinë ekstremiste dhe kanë promovuar përdorimin e dhunës për arritjen e qëllimeve ideologjike, përmes programeve të ndryshme, pasi të kenë vuajtur dënimin për veprën penale, ndihmohen që t'i kthehen normalitetit si qytetarë kontributdhënës në shoqëri.⁷⁵

Rehabilitimi nënkupton procesin përmes të cilit individët dikur të indoktrinuar me ideologji ekstremiste gradualisht distancohen nga grupet ekstremiste, i denoncojnë kauzat ideologjike dhe distancohen nga përdorimi i dhunës për arritjen e qëllimeve politike, sociale, ideologjike e ngjajshëm përmes këshillimit psikosocial, të menduarit kritik, interpretimit të drejtë të rregullave fetare dhe përfitimit të aftësive të reja që mund t'i përgadisnin për tregun e punës.⁷⁶ Në një formë, ky proces shpreson t'i kthejë këta individë të radikalizuar në gjendjen paraprake para rreshtimit të tyre krahas kauzave terroriste, kur individët kanë qenë pjesëtar të komunitetit të tyre me të gjitha përgjegjësitë e privilegjet dhe kur ata nuk kanë paraqitur kërkim për sigurinë kombëtare.⁷⁷

74 Council of Europe, Handbook for Prisons and Probation Services Regarding Radicalisation and Violent Extremism, 2016, <https://rm.coe.int/16806f9aa9>, p. 20

75 Për rekomandime dhe diskutim mbi politikë-bërje shih dokumentin e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) “Non-custodial Rehabilitation and Reintegration in Preventing and Countering Violent Extremism and Radicalization that Lead to Extremism: A Guidebook for Policy-makers and Practitioners in South-Eastern Europe,” Janar 2020, <https://www.osce.org/secretariat/444838>

76 Council of Europe, Handbook for Prisons and Probation Services Regarding Radicalisation and Violent Extremism, 2016, <https://rm.coe.int/16806f9aa9>

77 Ibid.

Reintegrimi, në anën tjetër, nënkupton rikthimin e tyre gradual në komunitet dhe shoqëri pasi të jenë distancuar nga grupet ekstremiste dhe t'i kenë ndryshuar bindjet e tyre që i kishin shtyer ata të përkrahin kauzat ekstremiste.⁷⁸

3.2 PËR ÇFARË NA DUHEN PROGRAMET E REHABILITIMIT DHE RIINTEGRIMIT?

Programet për rehabilitimin dhe reintegrimin e ekstremistëve të dhunshëm janë intervenimet institucionale apo të shoqërisë civile të dizajnuara për t'i distancuar individët e radikalizuar dhe përkrahësit e ekstremizmit të dhunshëm dhe për t'i ndryshuar bindjet e tyre ideologjike në mënyrë që ata të mos i rikthehen këtyre kauzave në të ardhmen. Programet e këtilla të rehabilitimit dhe reintegrimit zbatohen në dy ambiente – në burgje, ku individët e vuajnë dënimin, apo pas lirimit të tyre nga vuajtja e dënimit dhe kthimi i tyre në komunitet.⁷⁹

3.3 ÇFARË DUHET TË KEMI PARASYSH PARA SE TË FILLOJMË ME ZBATIMIN E PROGRAMIT TË REHABILITIMIT DHE RIINTEGRIMIT?

Programet për rehabilitimin dhe reintegrimin e individëve që e kanë përkrahur ekstremizmin e dhunshëm janë në esencë programe përmes të cilave institucionet shpresojnë të parandalojnë ndikimin e organizatave terroriste dhe përkrahjen e shoqërisë ndaj tyre.

Puna me individët që e kanë përkrahur ekstremizmin e dhunshëm dhe atyre që i janë ekspozuar ekstremizmit të dhunshëm është e vështirë nga aspekti i sigurisë dhe nga aspekti i resurseve. Kjo punë vështirësohet edhe më shumë nga problemet strukturore që i kanë shtyer këta individë t'iu bashkangjiten organizatave ekstremiste në radhë të parë, sepse ato probleme strukturore së bashku me motivet personale mund të jenë ende të pranishme në ambientin kur pritet të rehabilitohen këta individë.

Një sfidë tjetër me të cilën mund të përballen institucionet gjatë zbatimit të programeve rehabilituese dhe reintegruese është stigmatizimi i kësaj kategorie nga rrethi i vet dhe shoqëria e gjerë. Komuniteti mbetet jashtëzakonisht skeptik ndaj sinqeritetit të këtyre individëve për t'u rehabilituar dhe reintegruar në shoqëri si qytetarë kontributdhënës, por edhe i frikësuar nga rreziku që këta individë paraqesin për rrethin. Për shembull, në Barometrin e Sigurisë të realizuar nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë në vitin 2022, mbi 50% të të anketuarëve vazhdojnë të kenë qëndrim negativ ndaj reintegrimit të ish luftëtarëve në

⁷⁸ Ibid.

⁷⁹ Ibid.

komunitetin e tyre, apo t'i pranojnë që ata të jetojnë në komunitetet e tyre.⁸⁰ Dhe së fundi, suksesi i programeve rehabilituese dhe reintegruese do të varet nga përcaktimi i indikatorëve përmes të cilëve bëhet matja e transformimit të këtyre individëve. Ndonëse matja më e saktë për suksesin e kësaj ndërmarrje institucionale është përqindja e individëve recidivistë, një matje e tillë mund të mos jetë gjithmonë treguesi më i saktë i përpjekjeve të nëpunësve dhe zyrtarëve të shumtë të inkuadruar në këtë proces afatgjatë. Prandaj, është e rëndësishë parësore që çdo program rehabilitues të jetë i përcjellur me një plan monitorimi dhe vlerësimi me indikatorë qartazi të definuar.

3.4 QASJA: SI TË NDËRTOJMË BESIMIN NDËRMJET SHSK DHE LUFTËTARËVE TË HUAJ, GRUAS APO FËMIUT TË KTHYER?

Individët që i janë bashkangjitur organizatave terroriste dhe familjarët e tyre që i janë ekspozuar ekstremizmit të dhunshëm janë kategori që kanë kaluar nëpër përvoja të jashtëzakonshme traumatike.

Ata kanë qenë pjesëtarë të organizatave terroriste që kanë përdorur dhunë sistematike ndaj popullatës në vatrat e luftës të kontrolluara nga Shteti Islamik dhe grupet e ngjajshme.⁸¹ Ndonëse informacionet për përvojën e familjarëve të tyre në kampet e Shtetit Islamik janë të pakta, mjafton të supozohet se gratë mund të kenë qenë shënjestra të dhunës, kushteve të vështira në kampe dhe traumave të shkaktuara nga humbjet e familjarëve të tyre.

Një numër i këtyre individëve besohet që vazhdojnë të kenë bindje radikale fetare dhe qasje konzervatore e të mosbesimit në komunikim me institucionet shtetërore⁸². Kjo mungesë besimi në institucionet shtetërore rëndon barrën e Shërbimit Sprovues të Kosovës, por në të njëjtën kohë krijon mundësi për zyrtarët e këtij Shërbimi që përmes qasjes së tyre dhe misionit për t'i rehabilituar këta individë që ata të mos paraqesin më rrezik dhe kërcënim për sigurinë e Kosovës, të ndërtojnë një kapitull të ri marrëdhëniesh mes shtetit dhe kësaj kategorie të qytetarëve të tij.

Që proceset rehabilituese të jenë të suksesshme, praktikat e deritashme të përmbledhura nga organizatat ndërkombëtare që kanë ndërtuar ekspertizë në luftimin e dukurisë së ekstremizmit të dhunshëm, u bëjnë thirrje institucioneve dhe bartësve të tyre të investojnë në ndërtimin e besimit me të kthyerit nga vatrat e luftës duke mos i paragjykuar dhe duke zbatuar mandatin e tyre në përputhje

80

81 Shtuni, Adrian. 2021. "Rehabilitation and Reintegration Path of Kosovar Minors and Women Repatriated from Syria," International Republican Institute. <https://www.iri.org/resources/new-report-supports-rehabilitation-of-kosovo-youth-and-women-with-connection-to-violent-extremism/>

82 Ibid.

me normat ndërkombëtare dhe të drejtat e njeriut.⁸³

Se si të ndërtohet ky besim, SHSK-së i rekomandohet t'i marrë parasysh disa nga parimet e organizatës Hedaya të identifikuara në pjesën e dytë të këtij doracak.

Është tejet e rëndësishme që stafi i SHSK-së të trajnohet në vazhdimësi nga ekspertë mbi kërcënimin e ekstremizmit të dhunshëm, por që zyrtarëve që janë të ngarkuar me mbikqyrjen e këtyre rasteve t'iu ofrohet mundësi për kujdesje për shkak të ngarkesës psikologjike të punës me këto raste.

83 See discussion of gaps and opportunities in Erinda Bllaca Ndroqi's analysis "Dealing with returned women in the Western Balkans: challenges and opportunities from a practitioner's perspective," Radicalization Awareness Network, 2021 https://home-affairs.ec.europa.eu/system/files/2022-08/ran_wb_ad-hoc_dealing_with_returned_women_in_wb_082022_en.pdf

4. TERMET DHE TERMINOLOGJIA

Për të lehtësuar komunikimin mes zyrtarëve të SHSK-së dhe individëve nën mbikqyrjen e tyre që i janë ekspozuar ekstremizmit të dhunshëm, po e bashkangjesim një përmbledhje të termeve që mund ta ndihmojnë këtë institucion gjatë punës.

Xhihad – Siç është e përshkruar në Kuran dhe burime tjera fetare fjala “Xhihad” mund të ketë shumë kuptime. Me xhihad mund t’i referohemi përpjekjeve të besimtarëve musliman për të qenë besimtar të devotshëm dhe informimin e personave tjerë rreth besimit Islam. Fjala xhihad gjithashtu ka kuptimin e mbrojtjes së Islamit. Nëse për mbrojtjen e besimit Islam nuk funksionojnë metodat paqësore, atëherë lejohet edhe përdorimi i dhunës por me rregulla strikte të paracaktuara. Dëmtimi i të pafajshmëve, grave, fëmijëve dhe invalidëve është reptësisht i ndaluar në ekzekutimin e “Xhihadit Ushtarak” dhe cdo përpjekje paqësore e armikut duhet të pranohet. Megjithatë, aspekti ushtarak i xhihadit është vetëm njëri nga kuptimet e tij dhe nuk mund të kufizohet vetëm në këtë aspekt. Xhihadi, duhet të kuptohet vetëm në aspektin mbrojtës apo “Xhihadit defensiv” dhe asesi xihad ofenziv apo sulmues. Fjala arabe që i referohet luftës është “Al-Harb” prandaj interpretimi i fjalës “Xhihad” si “Luftë e Shenjtë” është e gabuar edhe në aspektin linguistik.⁸⁴

Xhihadi sipas ISIS – Organizatat terroriste siç janë Al-Kaida dhe ISIS vazhdimisht kanë keqpërdorur fjalën “Xhihad”. Ata e kanë interpretuar atë vetëm në kuptimin e ngushtë të luftës ofanzive dhe përdorimit të dhunës nga ana e muslimanëve ndaj jo-besimtarëve dhe të tjerëve që nuk ndajnë të njëjtën ideologji me ato grupe. Grupet terroriste përmes “Xhihadit” kanë tentuar ta legjitimojnë vrasjen e civilëve të cilët nuk i nënshtrohen urdhërave të grupeve terroriste. Grupet e tilla kanë bërë përpjekje që aktet e tyre ti fshehin nën petkun e “Xhihadit” si luftë për Allahun më tendencë për të arsyetuar luftën dhe dhunën që ata përdorin.⁸⁵

Xhihadist – Me termin “Xhihadist” në literaturën fetare quhen ata individ që angazhohen fuqishëm në ndjekjen dhe përhapjen e besimit Islam në mënyrë paqësore, pa i shkakuar dëme tjetrit dhe vazhdimisht bëjnë përpjekje për tu bërë besimtar sa më të devotshëm.⁸⁶

Xhihadist sipas ISIS – Njëjtë si te fjala “Xhihad”, në organizatat terroriste termi

84 For a full historical discussion of the term, see Encyclopedia Britannica’s definition <https://www.britannica.com/topic/ijihad>

85 “What is jihadism?” *BBC News*, Dec. 2014 <https://www.bbc.com/news/world-middle-east-30411519>

86 Ibid.

“Xhihadist” është i ngushtuar vetëm në aspektin e luftës ofanzive dhe përdorimit të dhunës. Sipas këtyre organizatave “Xhihadist” është çdo individ i cili lufton jo besimtarët, vendet perëndimore dhe shtetet sekulare si dhe përfaqon ideologjitë e organizatave terroriste.⁸⁷

Rekomandim – Rekomandohet që fjala “Xhihad” dhe “Xhihadist” të ketë përdorim minimal, apo të mos përdoret fare, kur diskutohet për organizatat terroriste. Me përdorimin e fjalës “Xhihad” për organizatat terroriste pa dashje legjitimohet kauza e tyre. Në vend të kësaj fjale mund të përmenden: masakrat, vrasjet, spastrimet etnike të kryera nga organizatat terroriste në emër të religjionit apo “Xhihadit”.

Viteve të fundit mediat më prestigjioze kombëtare dhe ndërkombëtare u janë referuar pjesëtarëve të organizatave terroriste si “xhihadist”. Duke iu referuar atyre si “xhihadist” iu bëhet një nder dhe në mënyrë indirekte i shërbehet kauzës së tyre.

Kalifati – Kalifati është noioni i një shteti Islamik të udhëhequr nga Kalifi, i cili është udhëheqës politik dhe religjioz i shtetit dhe përfaqëson të gjithë besimtarët e besimit Islam. Kalifati i fundit ka egzistuar në kohën e Perandorisë Osmane.⁸⁸

Kalifati sipas ISIS – ISIS ka arritur që përmes propagandës së tij të bind individ dhe grupe nga e gjithë bota se ata kanë krijuar kalifatin utopik të njohur si “Shteti Islamik i Sirisë dhe Irakut”. Sipas ISIS-it “Shteti i ri” është vendi ku mund të jetojnë të lirë të gjithë muslimanët dhe ka inkurajuar të gjithë t’i bashkohen atij dhe ta njohin liderin e tij si “Kalif” de fakto të të gjithë muslimanëve.⁸⁹

Si të përdoret – Rekomandohet që kur raportohet mbi “Shtetin Islamik” të futet në thonjëza apo t’i referohet si “i ashtuquajturi Shteti Islamik”.

Hadith – Afërsisht 200 vite pas vdekjes së profetit Muhamed porositë dhe veprat e tij janë përojellur gojarisht nga gjenerata në gjeneratë. Në shekullin e nëntë ka filluar mbledhjat dhe regjistrimi i fjalëve, veprave apo porositë së profetit të cilat tashmë njihen si Hadithe.⁹⁰

87 Ibid.

88 Center for Middle Eastern Studies, Harvard University, “Glossary of Terms related to Islam and Muslim Communities in Inter-Religious Settings,” <https://cmes.uchicago.edu/sites/cmes.uchicago.edu/files/uploads/Outreach/Resources/Religion/Glossary%20of%20Terms%20Related%20to%20Islam%20and%20Muslim%20Communities%20in%20Interregional%20Settings.pdf>
<https://cmes.uchicago.edu/sites/cmes.uchicago.edu/files/uploads/Glossary%20of%20Terms.pdf>

89 Mapping Militant Organizations. “The Islamic State.” Stanford University, last modified April 2021. https://cisoc.fsi.stanford.edu/mappingmilitants/profiles/islamic-state#text_block_18356

90 For a historical overview of the term see Encyclopedia Britannica under “Hadith” <https://www.britannica.com/topic/Hadith> dhe Center for Middle Eastern Studies, Harvard University, “Glossary of Terms related to Islam and Muslim Communities in Inter-Religious Settings,” <https://cmes.uchicago.edu/sites/cmes.uchicago.edu/files/uploads/Outreach/Resources/Religion/Glossary%20of%20Terms%20Related%20to%20Islam%20and%20Muslim%20Communities%20in%20Interregional%20Settings.pdf>

Kafir – ai që është mos mirënjohës, jobesimtar. Islami si një besim monoteist, dhe Kurani urdhëron besimin në një Zot të vetëm dhe premtion dënim për ata të cilët refuzojnë Perëndinë (Allahun si sundimtarin e vetëm të boërave) dhe janë jo besimtar ndaj tij.⁹¹

Përdorimi sipas ISIS – ISIS dhe grupet tjera terroriste e kanë përdorur fjalën Kafir për të gjithë ata të cilët nuk e kanë përqafuar ideologjinë e tyre terroriste. ISIS dhe grupet e tjera terroriste kafir i kanë quajtur të gjithë muslimanët tjerë të cilët nuk kanë qenë anëtarë të tyre dhe nuk kanë ndjekur agjendën e njejtë me këto grupe.⁹²

Daesh (Da'ish) – Fjala Daesh ka gjetur përdorim të gjerë në Lindjen e Mesme dhe jo vetëm për të ju referuar grupit terrorist "ISIS". Fjala Daesh kryesisht përdoret për të sfiduar legjitimitetin e grupit për shkak të konotacionit negativ të fjalës. Daesh në parim është akronim i shkronjave të para të emrit të vjetër të grupit, "al-Da'ala al-Islamiya fil Iraq ëa al-Sham". Edhe pse si fjalë nuk ka kuptim në gjuhën arabe, ajo tingëllon e pakëndshme dhe përkrahësit e grupit refuzojnë ta përdorin atë.⁹³

Sheriati – Sheriati është baza juridike islame dhe konsiderohet si sistem rregullues i jeteës dhe organizimit fetar e shteteror islam. Sheriati përfshinë udhëzime ligjore gjithëpërfshirëse për të gjitha fushat e jetës të cilat janë të justifikueshme dhe të pranueshme në Islam.⁹⁴ Parimet themelore të sheriatit janë përcaktues i modelit që një individ i besimit Islam duhet të ndjek për adhurimin e Allahut: Lutjet, humanizmi, agjërimi dhe pelegrinazhi. Në thelb, Sheriati është tërësia e urdhërave të Allahut sic janë të përcaktuara në librin e shenjtë të Kuranit dhe dokumentet tjera juridike.⁹⁵

Muxhahid – Muslimanët të cilët marrin pjesë në mbrojtjen e tokave të banuara me muslimanë, ose bëjnë përpjekje të ndryshme për të mbrojtur të shtypurit, të varfërit ose të shfrytëzuarit apo reagojnë kundër shtypjes së shtetit apo pushtuesit të huaj konsiderohen Muxhahedin. Muxhahid mund të quhet dikush edhe nëse nuk vdesë në fushëbetë, por vdesë duke i qëndruar besnik të vertëtës dhe xihadit në kuptimin e luftës së drejtë.⁹⁶

91 Akyol, Mustafa. 2019. "Who is a 'Kafir'?" Cato Institute, <https://www.cato.org/publications/commentary/who-kafir>

92 Counter-Terrorism Project, Glossary, 2023, <https://www.counterextremism.com/content/kafir>

93 "Isis, Isil, IS or Daesh? One group, many names," BBC News, Dec. 2, 2015 <https://www.bbc.com/news/world-middle-east-27994277>

94 For more, see Encyclopedia Britannica's definition and nuances of Sharia and its use <https://www.britannica.com/topic/Shariah> and in CMES's Glossary <https://cmes.uchicago.edu/sites/cmes.uchicago.edu/files/uploads/Glossary%20of%20Terms.pdf>

95 Christine Schirrmacher. "The Sharia – Law and Order in Islam" <https://christineschirrmacher.info/2013/05/the-sharia-law-and-order-in-islam/>

96 For more, see Encyclopedia Britannica's discussion of "mujahideen" in Islam, <https://www.britannica.com/topic/mujahideen-Islam>

Lufta e Shenjtë – Lufta e Shenjtë është njëra ndër përpjekjet për mbrojtjen e Islamit. Lufta e shenjtë për dallim nga Xihadi, është e kufizuar në kuptimin klasik të luftës. Megjithatë, lufta e shenjtë i ka rregullat e veta strikte se kur duhet të ndodhë dhe ajo mund të fillojë vetëm me shpalljen nga autoriteti legjitim fetar. Në Islam “Lufta e Shenjtë” mund të bëhet për vetëmbrojtje, kur një shtet sulmon një shtet islamik apo nëse një shtet, sekular apo jo, i sulmon qytetarët e vet të besimit islamik. “Lufta e Shenjtë” sipas Islamit duhet të zhvillohet në mënyrë të kujdesshme, pa e dëmtuar popullatën civile, të bëhet përdorimi minimal i forcës pa inate dhe zemërim dhe të burgosurit të trajtohen në mënyrë njerëzore dhe të dinjitetshme.

Organizatrat terroriste si ISIS ndër të tjerash i kanë shtrembëruar edhe parimet e “Luftës së Shenjtë”. Ata i kanë prezantuar vetëm elementet që ju përshtaten grupeve përkatëse dhe agjendave të tyre. “Lufta e Shenjtë” e proklamuar nga ISIS nuk përmban asnjë element të “Luftës së Shenjtë” të argumentuar përmes Kuranit dhe dokumenteve tjera religjioze. ISIS ka kryer krime të rënda ndaj civilëve, ka keqtrajtuar robërit e luftës dhe ka shpallur luftën e shenjtë pa qenë autoritet legjitim fetar, dhe lufta e tyre si e tillë nuk përkrahet nga bota muslimane.⁹⁷

Shteti Islamik – Shtet Islamik konsiderohet çdo sistem shtetëror i cili qeveriset në bazë të rregullave fetare islamike dhe si bazë kryesore të funksionimit të shtetit ka Ligjin e Sheriatit. Grupi terrorist “Shteti Islamik i Sirisë dhe Irakut(ISIS)” – doli në skenë në vitin 2014 pas marrjes në kontrollë të një pjese të madhe të Sirisë dhe Irakut. Realisht i ashtuquajtur “Shteti Islamik i Sirisë dhe Irakut” nuk mund të konsiderohet si shtet islamik për arsye të cilat mund të gjinden në pjesët tjera të këtij teksti. Shteti Islamik i Sirisë dhe Irakut ka pasur emërtime të ndryshme në mediat e ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare si: Shteti Islamik(IS), Shteti Islamik i Sirisë dhe Irakut (ISIS), Shteti Islamik i Sirisë dhe Levantit (ISIL) apo DAESH. Shumë media i janë referuar këtij grupi si “Grupi i Shtetit Islamik” për të qenë sa më neutral në raportimet e tyre dhe të mos krijojnë pa dashje lidhjen e këtij grupi me fenë islamike si tërësi.

Sunni – Është sekti më i madh në Islam, pjesë e të cilit janë 85% të muslimanëve në gjithë botën. Sunit kryesisht janë të shtrirë në vendet si: Egjipti, Siria, Arabia Saudite, Turqia, Afghanistani, Afrika e Veriut, Jordania, Palestina dhe shumica e popullatës muslimane në vendet e Ballkanit, përfshirë vendet shqipfolëse. Shumica e grupeve terroriste në botë si ISIS dhe Al-Kaida kanë pretenduar se i përkasin sekti Sunni.⁹⁸

Shiat – është sekti i dytë më i madh në fenë islame pas sekti Sunnit. Qendra e sekti Shia në botë është Irani. Numër i madh i popullatës Shia gjindet edhe

97 For more thorough discussion on ISIS and its war of attrition see US Institute of Peace’s “The Jihadi Threat: ISIS, Al-Qaeda and Beyond,” 2016/2017, <https://www.usip.org/sites/default/files/The-Jihadi-Threat-ISIS-Al-Qaeda-and-Beyond.pdf>

98 Për më shumë, shih Encyclopedia Britannica <https://www.britannica.com/topic/Sunni>

në Irak, Liban dhe Bahrejn. Përçarjet ndërmjet sektit Sunni dhe Shia datojnë që nga epoka e hershme e fesë islame dhe filluan rreth trashëgimtarëve të profetit Muhamed. Dy sektet kishin pikëpamje të ndryshme se kush duhet të jetë trashëgimtar dhe se çfarë rruge duhet ta ndjekin muslimanët në botë.⁹⁹

Kryeimam - Është autoriteti më i lartë fetar në interpretimin e ligjit kuranor dhe rregullimin fetar në vend me besim fetar të sektit sunnit. Ky titull zakonisht përdoret në kërë sekt. Në rastin e Kosovës ky titull lidhet me Myftiun e Kosovës, udhëheqësin e Bashkësisë Islame të Kosovës (BIK).

Imam - Me imam i referohet personit që kryen lutjet në Xhami apo udhëheqësit fetar lokal. Në Kosovë në përdorim e gjejmë fjalën hoxhë.

Kuran - është baza kryesore e fesë islame dhe njihet si Libri i Shenjtë. Sipas besimtarëve muslimanë, Kurani është fjala e Zotit (Allahut) dhe ajo çfarë thuhet në të është e domosdoshme të zbatohet dhe respektohet nga çdo musliman në botë.

Sahab/Sahabët - janë miqtë apo bashkëudhëtarët e profetit Muhamed. Dijetarët e ndryshëm islamikë kanë shprehur pikëpamje të ndryshme në lidhje me përkufizimin e "sahabit" (shoqëruesit). Sipas Hafiz Ibn Haxher al-Asqalani në librin e tij të quajtur "el-Isaba" ai l përkufizon "Sahabët" si "person që beson në Pejgamberin, erdhi së bashku me Profetin dhe vdiq si musliman".¹⁰⁰

Selefizmi - është një doktrinë islame që buron nga një hadith (thëniet dhe veprimet e Profetit Muhamed) që thotë: "njerëzit më të mirë janë ata që jetojnë në brezin tim, dhe pastaj ata që do të ndjekin ata, dhe pastaj ata të cilët do të ndjekin këta të fundit". Kjo është një thirrje për muslimanët që të ndjekin shembullin e atyre tre gjeneratave të para duke filluar me Pejgamberin, si referencat më të besueshme në interpretimin islam¹⁰¹. Në përgjithësi, salafistët janë më pak të prirur drejt angazhimit politik aktiv duke preferuar në vend të kësaj një qasje "të qetë" të predikimit në rrënjë të islamit, edukimit fetar dhe shmangies së konfrontimit me autoritetet shtetërore. Një pakicë e Selefitëve mund të quhen edhe si selefi-xihadistë, apo te dhunshëm, prej të cilëve janë motivuar një gurrp i organizatave terroriste.¹⁰²

Mënyra e përdorimit - Shpeshherë në media organizatave terroriste u janë referuar si "selefitë terroristë", shprehje e cila është e gabuar për shkak se me anë të atij etiketimi legjitimohen ato organizata dhe preket një komunitet më i

99 Për më shumë, shih Encyclopedia Britannica, <https://www.britannica.com/topic/Shii>

100 Hafiz Ibn Haxher al-Asqalani në librin e tij "el-Isaba."

101 Kursani, Shpend. 2015. "Shkaqet dhe pasojat..." http://www.qkss.org/repository/docs/Shkaqet_dhe_pasojat_e_perfshirjes_se_qytetareve_te_Kosoves_si_luftetare_te_huaj_ne_Siri_dhe_Irak_820753.pdf

102 Shih definicionin ne Oxford Research Encyclopedia of Religion, 2016, <https://oxfordre.com/religion/display/10.1093/acrefore/9780199340378.001.0001/acrefore-9780199340378-e-255;jsessionid=02266D-D47A0B2A6086230BEB37084C6A> dhe te "Islamism, Salafism and Jihadism" ne www.brookings.edu/blog/markaz/2016/07/15/islamism-salafism-and-jihadism-a-primer/

gjerë islamik që jo domosdoshëmrisht lidhet me terrorizmin. Në këto raste gjatë përdorimit të fjalës Selefi preferohet të përcillet me fjalët i/e dhunshëm ose i/e padhunshëm.

UMMA/Umeti Islamik – Është fjala arabe që nënkupton “Komunitet”, “Grup” apo “Kombësi”. Ky term merr konotacion religjioz në Kuran, ku thuhet se Zoti i ka dërguar secilit “Ummah” profetin e tij, Moisiun për hebrejtë, Jezusin për të krishterët dhe Muhamedin për muslimanët. Në parim, Ummah mund të përkrahë si koncepti modern i shtetësisë, por megjithatë në fenë islame “shtetësia” fitohet në bazë të përkushtimit ndaj religjionit, pavarësisht etnisë dhe “Umma” përfaqëson një rend botëror universal, të udhëhequr nga një qeveri islamike në bazë të ligjit të Sheriatit.

Ekstremizmi – Në ditët e sotme me ekstremizëm i referohemi kryesisht ideologjive politike dhe religjioze të cilat konsiderohen nga individë apo grupe të ndryshme si të papranueshme në konsensusin shoqëror. Megjithatë, fjala ekstremizëm nuk mund të kufizohet vetëm në ideologji të ndryshme, pasi që ajo përdoret edhe për të treguar diçka përtej normales ose një kundërshtim të fortë për diçka të caktuar. Me termin ekstrem nuk mund t'i referohemi vetëm një komuniteti apo ideologjie të caktuara, pasi ekstremja ka forma të ndryshme të manifestimit varësisht nga komuniteti/ideologjia.¹⁰³

Terrorizmi – Përdorimi i dhunës me qëllim të shkakimit të terrorit mbi popullatën civile. Terrorizmi është një lloj i veçantë i ekstremizmit të dhunshëm.

Nusja e xhihadistit – U referohet grave që mundohen të përhapin islamin, bëjnë përpjekje që të bëhen besimtare të devotshme dhe angazhohen fuqishëm që të ndjekë rrugën e Allahut, si dhe të përhapë religjionin në mënyrë paqësore duke mos shkakuar dëmë tjetrit.

Nusja e xhihadistit sipas ISIS është term i ri përdorur shumë së fundmi si pasojë e një numri të madh të grave të cilat kanë udhëtuar me burrat e tyre, apo të vetme për të jetuar dhe martuar me luftetarët e organizatave terroriste si ISIS.

Hoxhallarët e Hakut – Përkrahësit e grupeve ekstreme, përkatësisht ISIS-it në rrjete sociale janë aktiv në citimin dhe promovimin e imamëve nga Kosova, Maqedonia dhe Shqipëria të cilët janë të dënuar për vepra terroriste si rekrutimi apo nxitja e gjuhës së urrejtjes. Këta hoxhallarë sipas tyre quhen “Hoxhallarët e Hakut”. Ata janë imamët më kontravers të vendit, të cilët kanë qëndrime radikale karshi proceseve demokratike dhe rendit shtetëror. Gjatë ligjeratave apo shkrimeve të këtyre imamëve hasim në gjuhë të urrejtjes ndaj komunitetit Shia, besimit të krishterë dhe hebrejtëve. Zakonisht të ashtuquajturit “Hoxhallarët e Hakut” predikojnë një linjë tjetër të religjionit nga ajo që zyrtarisht praktikohet nga bashkësia fetare dhe shumica prej tyre kundërshtojnë publikisht bashkësitë

103 Per më shumë shih strategjia per parandalimin e ekstremizmit te dhunshëm. http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/STRATEGJIA_parandalim_-_SHQIP.pdf

islame në vendet përkatëse.¹⁰⁴

Hoxhallarët e Shtetit – janë prijësit fetarë muslimanë që kryesisht janë pjesë e Bashkësive Islame në vendet shqipfolëse të cilët praktikojnë islamin duke u bazuar në rregullat e përcaktuara nga institucionet fetare në vendet e tyre përkatëse. Këta imamë janë të kontraktuar nga bashkësitë fetare si institucionet zyrtare islame. Organizatat terroriste dhe përkrahësit e tyre nuk i njohin këta imamë si legjitim për shkak se nuk i kanë përkrahur ideologjitë e tyre të dhunshme dhe kanë kundërshtuar fuqishëm rekrutimin e qytetarëve të Kosovës për t'u bërë pjesë e organizatave terroriste. Grupet terroriste dhe përkrahësit e tyre këta imamë i konsiderojnë si tradhtarë për shkak se janë "hoxhallarë të shtetit sekular".

"Islami nën sulm" – ISIS dhe grupet tjera terroriste e kanë përdorur këtë argument për të rekrutuar luftëtarë të huaj. Sipas tyre "Islami është në rrezik" nga "kryqtarët dhe jobesimtarët" (Amerika dhe Perëndimi). Sipas tyre, Lindja e Mesme dhe Islami janë në rrezik për shkatërrim nga "imperialistët e perëndimit" (Amerika dhe kryqtarët) dhe se muslimanët e gjithë botës duhet të luftojnë dhe të mposhtin armikun e definuar sipas tyre. Poashtu, grupet terroriste si ISIS e të tjerët me këtë mesazh ju drejtohen edhe regjimeve dhe qeverive sekulare që qeverisin në vendet me shumicë muslimane, dhe sipas tyre edhe këta duhet luftuar.¹⁰⁵

Shejtan – Fjala shejtan në thelb do të thotë "i papastër" dhe "i ulët/i pavlerë". Shejtan i referohet një entiteti të rebeluar, pavërsisht a është në formën e njeriut, kafshës apo xhindeve. Shejtan sipas fesë islame mund të konsiderohet "një shpirt i neveritshëm që është distancuar nga Allahu dhe e vërteta".¹⁰⁶

Dabiq – Dabiq është qytet në Sirinë Veriore. Sipas fesë Islame, Dabiq do të jetë vendi në të cilën do të zhvillohet beteja përfundimtare mes forcave islamike dhe armiqëve të tyre të krishterë. Në këtë rast ISIS i interpreton si forcat e krishtera Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Profecia e Dabiq-it është e ngjajshme me gojëdhënat e krishtërizmit për një betejë përfundimtare mes forcave krishtere dhe atyre "anti-Krisht" para fitores së madhe të Perëndisë.¹⁰⁷ Dabiq është edhe emri i revistës propagandistike të ISIS-it.

Xhehnet – Parajsa në islam është e njohur si Xhehneti. Xhehneti rrjedh nga një fjalë Arabe që ka kuptimin "të mbulosh ose të fshehësh diçka". Sipas Kuranit, Xhehneti është "Jeta e përjetshme e paqes dhe lumturisë pas vdekjes, ku

104 Kelmendi, Vese dhe Shpat Balaj. 2017. "New Battlegrounds: Extremist Groups' Activity in Social Media in Kosovo, Albania and FYROM," KCSS, http://www.qkss.org/repository/docs/Neë_Batelgrounds_Extremist_Groups_in_Social_Media_738865.pdf

105 Per më shumë shih: <https://www.brookings.edu/wp-content/uploads/2016/06/The-ideology-of-the-Islamic-State.pdf>

106 <https://www.al-islam.org/180-questions-about-islam-vol-2-various-issues-makarim-shirazi/7-what-meant-shaytan-noble-quran>

107 <http://www.bbc.com/news/world-middle-east-30083303>

besimtarët dhe të drejtët do të shpërblehen”.¹⁰⁸

Al Qaida - Al Qaida rrjedh nga fjala Arabe e cila do të thotë “Baza” apo “Themeli”. Al Qaida është organizatë terroriste e dedikuar për eliminimin e pranisë ndërkombëtarë në vendet arabe të cilët kundërshtuan ushtarakisht politikat e jashtme perëndimore. Al Qaida u themelua nga Osama bin Laden në vitin 1988.¹⁰⁹

Taghut - Fjala taghut rrjedh nga fjala “Tugyan” e cila do të thotë “të tejkalojë kufijtë/limitet”. Taghut sipas fesë islame është “kushdo që tejkalon limitet duke i veshur vetës të drejta që i takojnë vetëm Allahut dhe e bën vetën partner me Allahun”. Me taghut poashtu nënkuptohet çdo adhurim ndaj dikujt/dicka tjetër përveç Allahut, e cila konsiderohet e ndaluar sipas fesë islame.¹¹⁰ Shtetet sekulare dhe të cilat nuk funksionojnë në bazë të parimeve fetare islamike njihen si “taghut” nga organizatat terroriste. Organizatat terroriste bëjnë thirrje tek të gjithë muslimanët që t’i përdorin të gjitha mjetet e mundshme për luftimin e shtetit të taghutit, dhe të zbatojnë parime fetare islamike në funksionimin dhe qeverisjen e shtetit.

Komunitetet e qëndrueshme - nënkupton angazhimin aktiv të komunitetit dhe aktorëve të ndryshëm të pajisur me njohuritë dhe mekanizmat bazik për të parandaluar dhe luftuar ekstremizmin e dhunshëm. Kjo poashtu përfshin qëndrimin e komunitetit ndaj një fenomeni të tillë dhe reagimin e tyre në prag të shfaqjes së aktivitetit të dhunshëm ose ngjarjeve që shpien në aktivitete të tilla.

Shami – Shami është fjala arabe me të cilën u emërua rajoni i Sirisë (Siria e sotme, Libani, Jordania, Izraeli, Palestina dhe pjesë e Turqisë jugore) pas pushtimit të kësaj zone nga arabët, e cila deri në shekullin e 7-të i takoi Perandorisë Bizantine.

Kryqali - Propaganda e organizatës terroriste të ashtuquajtur “Shteti Islamik” (ISIS) dhe përkrahësve të tyre vazhdimisht i referohet botës perëndimore si “Kryqalitë”. Kryqalitë sipas tyre janë ata të cilët gjatë gjithë historisë kanë pasur synim zhdukjen e islamit dhe vazhdojnë të shtypin muslimanët në botë. Narracioni i “Kryqalive” realisht nuk ka ndonjë bazë të qëndrueshme historike, megjithatë përbën një element të fortë propagandues pasi me përdorimin e këtij termi në konotacion negativ synohet mobilizimi i masës për “kundërpërgjigje ndaj shtypjes” që gjoja po u bëhet muslimanëve në botë.

Munafik - Me Munafik besimtarët e islamit i referohen mohuesve të fesë së tyre dhe Zotit. Ata konsiderohen hipokritë dhe të rrezikshëm për fenë islame.

Takfir – Takfiri është deklaratë teologjike që i referohet dikujt që mohon fenë e tij, një personi jo besimtar apo një akti apo ideje që përbënë mosbesim në

108 <https://www.thoughtco.com/definition-of-jannah-2004340>

109 <https://www.counterextremism.com/threat/al-qaeda>

110 <http://from.the.depths.of.darkness.into.light.over-blog.com/article-71795909.html>

Islam. Të qenit tekfir është çështje tejet serioze në islam pasi konsiderohet mëkat i madh që do të bartë pasoja në jetën pas vdekjes.¹¹¹

Sulmet vetvrasëse – janë ndër metodat e shpeshta që ISIS dhe grupet tjera terroriste i kanë përdorur për të sulmuar vendet dhe qytetarët në Lindje të Mesme, Perëndim dhe vende tjera. Kjo ka qenë një taktike shumë e njohur dhe e përdorur nga ISIS së fundmi pas humbjeve të mëdha që i ka pësuar nga ana e forcave të sigurisë irakiane dhe siriane si dhe sulmeve të koalicionit të udhëhequra nga SHBA ndaj ISIS dhe grupeve tjera terroriste aktive në Siri dhe Irak. Para se të përdoren nga grupet terroriste në Lindje të Mesme, sulmet vetvrasëse janë ndërmarrë nga pilotët kamikaz japonez gjatë Luftës së Dytë Botërore si dhe nga nga guerrilët tamil në Shri Lankë.

Shteti Sekular – Kur një shtet është neutral sa i përket religjionit, nuk kundërshton apo përkrah asnjë religjion, praktikat apo aktivitetet e tyre, por në të njëjtën kohë ua garanton dhe siguron të drejtat për praktikimin e besimit qytetarëve pa asnjë dallim. Një shtet sekular i trajton qytetarët e tij në mënyrë të barabartë, pavarësisht besimit apo mos-besimit në një religjion të caktuar.

Shteti Sekular sipas ISIS – Organizatat terroriste si ISIS dhe përkrahësit e tyre kundërshtojnë fuqishëm shtetet sekulare. Sipas tyre, muslimanët nuk duhet të qeverisen nga të “pafe” dhe madje promovojnë idenë e moskryerjes së obligimeve financiare ndaj shtetit, mosedukimin e fëmijëve në shkolla publike apo ndalimin e punësimit në institucionet e shtetit sekular pasi kësioj, sipas tyre, ndihmohet lufta ndaj islamit. Ata kundërshtojnë idenë e sekularizmit për shkak se konsiderojnë se është në kundërshtim me “Ligjet e Allahut” dhe pjesëmarrja në proceset demokratike të një shteti, sikur zgjedhjet, janë vepër e denueshme sipas islamit.¹¹²

Shkëputje (Disengagement) – Shkëputja apo tërheqja nga sjellja dhe ideologjia ekstremiste e dhunshme e individëve të radikalizuar apo atyre që e kanë mbështetur kauzën e organizatave terroriste. Kjo shkëputje mund të bëhet në dy forma. E para, përmes distancimit të ekstremistit të dhunshëm pas vetëdijësimit individual për kauzën e gabueshme që individi e ka përqaftuar si pasojë e denoncimit shoqëror apo, së dyti, përmes intervenimeve programatike institucionale për deradikalizim.¹¹³

Intervenimet – intervenimi kryesisht i referohet programeve institucionale të dizajnuara enkas për ta penguar radikalizimin e mëtutjeshëm të individëve dhe përfshirjen e tyre në kauza ekstremiste të dhunshme. Këto intervenime mund të jenë të shumëllojshme, duke filluar nga programe artizanale e deri te fushatat e

111 <http://www.css.ethz.ch/en/services/digital-library/articles/article.html/316b8048-d26a-44cb-b4ce-48d8167f1c7c/pdf>

112 http://www.qkss.org/repository/docs/Fushebetejat_e_reja_Aktiviteti_i_grupeve_ekstremiste_on-line_900090.pdf

113 Council of Europe, 2016, Handbook.

komunikimit strategjik që e kanë për qëllim ta vetëdijësojnë shoqërinë për dëmet që i sjellë ekstremizmi i dhunshëm.¹¹⁴

Luftetar i huaj – individ i cili udhëton në një arenë luftimesh për t’u bashkangjitur palëve të armatosura dhe organizatave terroriste për të kryer akte terroriste. Në kontekstin e Shtetit Islamik, besohet që nga viti 2015 deri në humbjen e këtij grupi më 2017 rreth 40,000 luftëtarë të huaj nga 120 shtete i janë bashkangjitur ISIS-it dhe shumica e tyre kanë jetuar nën sundimin e kësaj organizate. Kësaj organizate nga Kosova i janë bashkangjitur mbi 200 shtetas.

Perëndimi – Në gjuhën e ISIS-it dhe pjesëtarëve të saj, Perëndimi paraqet “të keqen” si tërësi homogjene territoriale dhe ideologjike e politike. Në propagandën e ISIS-it Perëndimi përshkruhet si armiku kryesor i muslimanëve, entitetet i pafe e mëkatar, dhe frymë që duhet rezistuar dhe luftuar.

Perëndimi imperialist – Ngjajshëm sikur më lart, ISIS e ka portretizuar Perëndimin si frymë e cila synon të korrutojë islamin, ta dobësojë dhe t’ia përshtatë atë interesave të veta në veçanti çër të zbehur rezistencën ndaj shfrytëzimit të resurseve dhe për dominim kulturor në përplasjen e civilizimeve. Në propagandën e ISIS-it dhe grupeve tjera terroriste me agjendë islamiste, Perëndimi është i definuar si forcë negative, në të cilën përfshihen të krishterët, SHBA-të dhe shtetet arabe që sipas këtyre grupeve janë të korruptuara.¹¹⁵

Islami nën sulm – Ky sllogan është pjesë qenësore e propagandës së ISIS-it dhe grupeve të ngjajshme terroriste dhe ekstremiste me agjendë islamiste, të cilave u shërben për të legjitimuar dhunën dhe aktet terroriste gjoja në mbrojtje të islamit. Në përpjekje për të siguruar mbështetjen dhe mobilizimin e muslimanëve duke u thirrur në identitetin e tyre fetar për ta konsoliduar kontrollin e tyre territorial si hap drejt ndërtimit të Kalifatit (shtetit) islamik të udhëhequr në bazë të interpretimit të tyre të ligjit islamik (Sheriatit), këto organizata e portretizojnë islamin si civilizim që kërcënohet nga Perëndimi i korrptuar. Ato shfrytëzojnë shembuj të islamofobisë apo përplasjet mes fesë dhe shtetit sekular në sferën publike, në veçanti në shtetet evropiane, për të ndërtuar argumentin se islami si besim dhe mënyrë e jetës e miliona muslimanë përreth botës po sulmohet qëllimisht nga të krishterët dhe jobesimtarët.

Shamia apo Nikabi – shamia, e quajtur shpeshherë hixhab nga gjuha arabe, konsiderohet nga shumë besimtarë muslimanë si obligim për t’u mbajtur nga gratë muslimane që nga mosha e pubertetit. Hixhabi mbulon kokën dhe qafën, ndërkohë që një mbulesë tjetër e përdorur nga gratë muslimane është edhe nikabi, që mbulon pjesën më të madhe të fytyrës, duke lënë të hapur vetëm pjesën e syve. Mbulesa e këtillë i ka rrënjët në shprehjen e religjiozitetit, ndonëse

114 Ibid.

115 Shih https://ore.exeter.ac.uk/repository/bitstream/handle/10871/36626/IsisWest_MainArticle.pdf;jsession-id=8136E61F7D438286545EE277A90BBEF2?sequence=1

mbetet e paqartë nëse ajo është kërkesë eksplicite e Kuranit apo çështje e interpretimit të tij. Në dekadën e fundit, shamia është bërë pjesë e debateve të shumta polarizuese identitare në Evropë, përfshirë në kontekstin e të drejtave themelore të njeriut, por edhe të vlerave dhe lirive liberale siç është e drejta për të ushtruar liritë fetare dhe karakteri laik i shtetit që e sheh shtetin dhe institucionet e tij të ndara nga feja dhe ndikimi i saj.

Ekstremizmi pasiv dhe aktiv – Ekstremizmi aktiv dhe pasiv në kontekstin e aktivitetit që çon në terrorizëm zakonisht i referohet rolit të shtetit si aktor në lejimin indirekt apo sponsorimin e qëllimshëm të organizatave ekstremiste. Me lejim indirekt nënkuptojmë sjelljen pasive të institucioneve shtetërore, pra mosndërmarrjen e masave konform ligjeve në fuqi, për parandalimin e krijimit të këtyre grupeve terroriste, mobilizimin e përkrahjes, rekrutimin e përkrahësve për kauzat e tyre apo ndërtimin e infrastrukturës financiare dhe rekrutuese.¹¹⁶ Shtetet janë rrallëherë sponsorizuese të qëllimshme të terrorizmit, por megjithatë ka raste sikur me shembullin e Iranit, strukturat shtetërore të së cilit mbështesin financiarisht dhe me armatim grupet terroriste sikur Hezbollahu dhe së fundi Hamasin në Lindje të Mesme. Ndërkohë në nivelin individual, dallimi mes ekstremistit pasiv dhe aktiv është vendimi i një individi të ndërmarrë veprime konkrete për realizimin e qëllimeve ekstremiste. Ekstremist pasiv mund të jetë një individ që ka botëkuptime ekstremiste, mbështetë ideologjikisht kauzat e grupeve ekstremiste dhe ndanë qëndrimet e tyre, dhe që konsumon përmbajtje ekstremiste përmes literaturës ose në rrjete sociale, por që nuk vepron për t'i realizuar ato qëllime. Ndërkohë, ekstremist aktiv është individi i cili i bashkohet kauzës ekstremiste dhe përdorë dhunë për arritjen e qëllimeve të grupit ekstremist apo i propagon kauzat ekstremiste për të mbjellur jotolerancë dhe për të rekrutuar përkrahës.

Anti-semitizëm – Sipas Aleancës Ndërkombëtare për Përkujtimin e Holokaustit (IHRA), antisemitizmi definohet si "perceptimi specifik i hebrenjëve, i cili mund të shprehet si urrejtje ndaj hebrenjëve. Manifestimet retorike dhe fizike të anti-semitizmit i kanë për cak hebrenjtë dhe johebrejtë dhe pronën e tyre, institucionet e komunitetit hebre dhe objektet e tyre fetare." Shumë shtete i konsiderojnë sulmet antisemite si vepra penale. Sipas IHRA, këto kategori përbëjnë antisemitizëm: thirrjet apo justifikimi për vrasjen apo përndjekjen e hebrenjëve në emër të një ideologjie radikale apo për shkak të pikëpamjeve ekstremiste fetare; referencat dehumanizuese apo akuzat stereotipizuese për hebrenjtë si popull apo për fuqinë e hebrenjëve si grup, në veçanti që lidhen me mitet konspirative për hebrenjtë si fuqi botërore apo si kontrollues të mediave, ekonomisë, qeverisë dhe institucioneve të tjera shoqërore; akuzat ndaj popullit hebre si janë përgjegjës për keqmbajtjen e një hebrenjësi apo një grupi të caktuar hebrenjesh; mohimi i

116 Byman, Daniel L. 2005. "Confronting Passive Sponsors of Terrorism," The Saban Center for Middle Eastern Policy at Brookings Institution, <https://www.brookings.edu/wp-content/uploads/2016/06/byman20050201.pdf>

gjenocidit/Holokaustit ndaj hebrenjëve nga Gjermania naziste dhe përkrahësit e saj gjatë Luftës së Dytë Botërore; akuzat ndaj hebrenjëve që janë më lojal ndaj Izraelit dhe interesave të tij se sa ndaj shteteve ku jetojnë dhe veprojnë; mohimi i së drejtës së hebrenjëve për vetëvendosje (duke e cilësuar themelimin e shtetit të Izraelit si ndërmarrje raciste), aplikimin e standardeve të dyfishta që nuk kërkohen nga shtetet tjera demokratike; përdorimin e simboleve dhe imazheve që asociojnë me antisemitizmin klasik (sikur klasifikimi i hebrenjëve si vrasës të Krishtit) për ta përshkruar Izraelin; tërheqjen e paraleleve mes politikës aktuale që e ndjekë Izraeli dhe nazistëve dhe fajësimi kolektiv i hebrenjëve për veprimet e shtetit të Izraelit.¹¹⁷

Toka e Shamit – I referohet tërësisë territoriale të rajonit historik në lindje të Detit Mesdhe, të njohur edhe si Levanti apo Siria e Madhe. Kjo referencë është përdorur gjatë sundimit të kalifëve muslimanë në shekullin e 7-të për ta përshkruar territorin gjeografik mes Mesdheut dhe Euftratit, lumit më të madhe në Lindje të Mesme, Turqisë dhe Egjiptit.

Politizimi i religjionit – shumica e shteteve demokratike janë shtete sekulare dhe kushtetutat e tyre apo traditat qeverisëse nuk e trajtojnë një fe të posaçme apo një doktrinë fetare si religjion zyrtar. Sekularizmi nënkupton poashtu spostimin e bindjes fetare në sferën private nga sfera publike e cila është e përbashkët. Këto shtete i trajtojnë qytetarët e tyre, dhe rrjedhimisht edhe religjionet ose përkatësitë e tyre fetare si të barabarta mes vete. Sekularizmi nënkupton edhe një ndarje mes institucioneve shtetërore dhe institucioneve fetare dhe mospërfshirjen e tyre në punët e njëra tjetrës. Megjithatë, shumë shtete sekulare e evokojnë Zotin si inspirim qoftë në garantimin e të drejtave të barabarta mes njerëzve qoftë në çështje tjera morale.

Në kontekstin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit, kur flitet për politizimin e fesë zakonisht i referohet manipulimit të saj përmes interpretimeve të cilat u shkojnë për shtati qëllimeve politike dhe ideologjike individëve dhe organizatave që e proklamojnë një manipulim të tillë. Manipulimi i religjionit shpeshherë krijon polarizim shoqëror që manifestohet me mungesë tolerance dhe dhunë.

Islami politik – sipas Universitetit të Oxfordit (Oxford Bibliographies),¹¹⁸ islami politik është çdo interpretim i fesë islame që përdoret si bazë për identitet dhe ndërmarrje politike, përfshirë nga lëvizjet politike të cilat synojnë të mobilizojnë përkrahje duke u thirrur në Islam.

Muslimanët pluralist – Muslimanët pluralistë janë muslimanët e devotshëm të cilët besojnë në llojllojshmërinë identitare të shoqërisë dhe tregojnë tolerancë për religjionet e tjera. Këta besimtarë nuk shohin kundërthënie mes besimit të

117 Per me shume detaje rreth definicionit te IHRA, shih <https://www.holocaustremembrance.com/resources/working-definitions-charters/working-definition-antisemitism>

118 Per me shume, shih Oxford's Bibliographies <https://www.oxfordbibliographies.com/display/document/obo-9780195390155/obo-9780195390155-0063.xml>

tyre dhe vlerave të shtetit sekular i cili e promovon diversitetin.

Islami tradicional shqiptar – e gjejmë shpesh në përdorim si term për ta përshkruar bashkëjetesën dhe harmoninë e fesë islame dhe shtetit sekular gjatë kohës kur Kosova ishte pjesë e Jugosllavisë socialiste dhe rreshtimit të krerëve fetarë me lëvizjet politike të vendit që e kishin agjendën politike kombëtare të çlirimit dhe pavarësisht të Kosovës në vitet e 90-ta. Në esencë, Islami tradicional shqiptar i ka rrënjët në shkollën Hanefi të interpretimit të islamit që ka ardhur në rajonin tonë përmes Perandorisë Osmane. Kjo shkollë e interpretimit të islamit shquhet për tolerancë ndaj besimeve tjera dhe e hapur ndaj vlerave të përbashkëta liberale, përfshirë harmoninë me shtetin sekular dhe mosimponimin e fesë ndaj tjetrit.¹¹⁹

Hoxhallarët ose imamët e moderuar – studiuesit e ekstremizmit fetarë i definojnë si “imamë të moderuar” ata prijës fetarë të cilët nuk e mbështesin keqinterpretimin e islamit dhe nuk i promovojnë kauzat konzervative dhe të dhunshme të organizatave islamiste. Këta hoxhallarë besojnë në bashkëjetesë krahas feve tjera dhe angazhohen për tolerancë ndaj besimeve të tjera dhe jobesimtarëve, si dhe provojnë t’i kundërshtojnë kauzat dhe ideologjitë që e legjitimojnë arritjen e qëllimeve politike e ideologjike me dhunë. Njëkohësisht, këta imamë nuk e shohin shtetin sekular dhe demokracinë në kundërtënie me bazamentin e islamit.

Islami i moderuar – ndonëse nuk ekziston si rrymë e veçantë brenda islamit, në studimet e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit një koncept i tillë është përdorur për ta bërë dallimin mes shumicës së muslimanëve të devotshëm, të cilët e kundërshtojnë përdorimin e dhunës për arritjen e qëllimeve politike dhe ideologjike, dhe atyre muslimanëve që promovojnë dhunën sim jet politik. Ky term është paksa kundërtënës dhe gjithsesi i papërsosur edhe për faktin që asnjë fe nuk është e moderuar më vete meqë secila promovon të vërtetën e vet të plotë dhe të pakontestueshme.

119 Per me shume, shih eseun e Xhabir Hamitit, “Cka nenkuptojme me Islamin tradicional?” <https://albemi-grant2011.wordpress.com/2014/01/16/profesor-xhabir-hamiti-cka-nenkuptohet-me-islam-tradicional/>

Katalogimi në botim **(CIP)**

Biblioteka Kombëtare e Kosovës - "Pjetër Bogdani"

323.28:297(496.51)(038)

Kraja, Garentina

Doracak rreth kontekstit të terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm në Kosovë / Garentina Kraja, Skënder Perteshi - Prishtinë : Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, 2023. - 28 f. ; 24 cm.

Terrorizmi -- Feja islame -- Kosovë
Doracakë

ISBN 978-9951-799-86-7

ISBN 978-9951-799-86-7



9 789951 799867